

RAPORT MONITORIMI NE KUADER TE PROJEKTIT ``KONCESCAN``



PERGATITUR NGA OPEN DOORS

TIRANE, 2018

PJESA I

@OPENDOORS, SHQIPERI, Tirane, 2018

Ky raport është produkt i projektit “KONCESCAN” i cili zbatohet nga Qendra “Open Doors” mbështetur nga projekti LëvizAlbania që financohet nga Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare të suksesshme, "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-Plan".

Grupi i punës:

Rezear Xhaxhiu, Drejtor Ekzekutiv i Qendres “Open Doors”

Grupi i ekspertëve të projektit:

- Ela Tollkuci
- Kondi Ilia
- Agim Hajdari
- Donald Jorgoni

Ky raport u realizua me mbështetjen e **LëvizAlbania**. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e **LëvizAlbania**.

OPEN DOORS

Email: opendoors_center@yahoo.com

Email: info@opendoors-albania.org

<http://www.opendoors-albania.org>



PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
LISTA E SHKURTIMEVE.....	7
MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME.....	8
HYRJE RRETH RAPORTIT TË MONITORIMIT.....	9
KAPITULLI I.....	10
1.0 TRANSPARENCA E PUSHTETIT VENDOR.....	10
1.1 Çfarë përkufizohet me transparencë të pushtetit vendor?.....	10
1.2 Çështje të Transparencës në Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore.....	11
KAPITULLI II.....	13
2.0 NATYRA E KONTRATAVE KONCESIONARE PËR BASHKITË FIER DHE DIVJAKË.....	13
2.1 Çfarë janë kontratat koncesionare?.....	13
2.2 Legjislacioni Shqiptar në fuqi mbi kontratat koncesionare.....	14
2.3 Veçantitë e kontratave koncesionare për dy bashkitë në shqyrtim.....	15
2.4 Pritshmëritë mbi zhvillimet e ardhshme të kontratave.....	30
KAPITULLI III.....	31
3.0 SITUATA AKTUALE E ÇËSHTJEVE DHE PROBLEMATIKAVE NË ZHVILLIMIN SOCIAL NË BASHKITË E FIERIT DHE DIVJAKËS...	31
3.1 DINAMIKAT SOCIALE TË POPULLSISË PËR BASHKITË E FIERIT DHE DIVJAKËS NË RAJONIN E FIERIT.....	31
3.1.1 Popullsia prezente.....	31
3.1.2 Migrim/Emigrim.....	32
3.1.3 Niveli Arsimit.....	38
3.1.4 Shëndetësia.....	41
3.1.5 Punësimi dhe Papunësia.....	42
3.2 PJESËMARRJA E KOMUNITETIT NË QEVERISJEN VENDORE, ROLI I MEDIAS DHE SHOQËRISË.....	47
3.2.1 Pjesëmarrja publike në qeverisjen vendore për bashkitë e Fierit dhe Divjakës.....	47
3.2.2 Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje.....	49
3.2.3 Mënyrat e pjesëmarrjes qytetare.....	49
3.2.4 Hapat për pjesëmarrjen qytetare.....	50
3.3 VLERËSIMI MBI PJESËMARRJEN DHE ANGAZHIMIN QYTETAR. EKSPERIENCA TË PRAKTIKAVE TË MIRA BOTËRORE.....	51
3.3.1 Marrëveshjet ndërkombëtare, legjislacioni në fuqi dhe situata konkrete për Bashkitë e Shqipërisë.....	51
3.3.2 Eksperienca konkrete botërore të pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje.....	54
3.4 DINAMIKA TË STRESIT MJEDISOR DHE NDIKIMET E TIJ TEK	57

INDIVIDËT NË KOMUNITET.....	57
3.4.1 Përkufizimi i stresit mjedisor kronik.....	57
3.4.2 Çfarë njihet si stres mjedisor?.....	58
3.4.3 Faktorët psikologjikë që i përgjigjen stresit mjedisor.....	59
3.4.4 Pesë stresorët më të zakonshëm të mjedisit.....	59
KAPITULLI IV.....	60
4.0 VLERËSIMI MJEDISOR PËR FIERIN DHE DIVJAKËN. ASPEKTE DHE PROBLEMATIKA SPECIFIKE TË NDOTJES SË TOKËS, UJIT DHE AJËRIT PËR SECILËN BASHKI.....	60
4.1 VEÇANTITË MJEDISORE SIPAS SPECIFIKAVE TERRITORIALE.....	61
4.1.1 Veçantitë mjedisore për qarkun Fier.....	61
4.1.2 Bashkia Divjakë. Veçantitë mjedisore për zonën e plazhit.....	64
4.2 KRITER PËR MBROJTJEN E MJEDISIT GJATË ZBATIMIT TË KONTRATAVE KONCESIONARE PËR QARKUN FIER DHE BASHKINË DIVJAKË.....	65
4.2.1 Rrezikshmëri për ndotje gjatë zbatimit të kontratës koncesionare në Qarkun Fier.....	65
4.2.3 Kriter për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të kontratës koncesionare 'dhënia me qera e 338 kabinave në plazhin e Divjakës` (Bashkia Divjakë).....	73
KAPITULLI V.....	77
5.0 ANALIZA MBI PËRFITIMET EKONOMIKE NGA KONTRATAT KONCESIONARE PËR BASHKINË E FIERIT DHE DIVJAKËS.....	77
5.1 VLERËSIMI EKONOMIK MBI PROJEKTIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË QARKUN E FIERIT.....	77
5.1.1 Hyrje.....	77
5.1.2 Situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në qarkun e Fierit.....	79
5.1.3 Vlerësimi i projektit.....	81
5.1.4 Partneri Privat.....	81
5.1.5 Partneri Publik.....	86
5.1.6 Përfitime të tjera ekonomike të Partneritetit Publik.....	87
5.2 TË DHËNA EKONOMIKE MBI DHËNIEN ME QERA TE ASETJEVE NE BASHKINE DIVJAKE, NE FUNKSION TE TRASPARENCE PER SHERBIMIN PUBLIK.....	89
5.3 OBJEKTET ME KONTRATË QERAJE AKTIVE.....	118
5.4 OBJEKTET PA KONTRATË QERAJE (APO PRISHUR KONTRATA).....	120
5.5 OBJEKTE TE PRIVATIZUARA.....	122
KAPITULLI VI.....	125
6.0 PJESA STUDIMORE.....	125
6.1 QËLLIMI I STUDIMIT.....	125
6.2 ANALIZA E TË DHËNAVE.....	125

KAPITULLI VII.....	150
7.0 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	150
7.1 KONKLUSIONE MBI ANALIZËN E DOKUMENTUAR DHE STUDIMORE TË KONTRATAVE KONCESIONARE.....	150
7.2 REKOMANDIME MBI ANALIZËN E DOKUMENTUAR DHE STUDIMORE TË KONTRATAVE KONCESIONARE.....	154
REFERENCAT.....	159
SHTOJCA 1.....	164

LISTA E TABELAVE

Faqe

Tabela. 1 Nivelet arsimore të Bashkisë Fier dhe Bashkisë Divjakë, në raport me nivelin Kombëtar dhe Qarkun Fier.....	39
Tabela. 2 Pasqyra përmbledhëse e objektivave të planit dhe aksioneve të parashikuara për t'u arritur.....	74
Tabela. 3 Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.....	79
Tabela. 4 Burimi: Bashkia Fier.....	80
Tabela. 5 Burimi: Studim Fizibiliteti. Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë.....	82
Tabela. 6 Burimi: Teknologjia e energjisë së ripërtërishme: seria e analizës së kostos.....	83
Tabela. 7 Burimi: Studim Fizibiliteti. Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë.....	86
Tabela.8 Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	88
Tabela. 9 Vlera fillestare e aseteve në bashkinë Divjakë.....	89
Tabela. 10 Paraqitja e objekteve sipas VKB-së.....	91
Tabela. 11 Mbi pritshmëritë e të ardhurave për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016.....	106
Tabela. 12 Analiza e vitit 2011.....	106
Tabela. 13 Analiza e vitit 2012.....	107
Tabela. 14 Analiza e vitit 2013.....	108
Tabela. 15 Analiza e vitit 2014.....	109
Tabela. 16 Analiza e viteve 2015-2016.....	110
Tabela. 17 Efektet negative ne bilancin e bashkise ne zerin e pakësimit te aseteve si dhe ne pamundesine e gjenerimit te te ardhurave.....	114
Tabela. 18 Kontratat e prishura per mos shlyerje detyrimi.....	114
Tabela. 19 Vendlindja dhe vendbanimi i pjesëmarrësve.....	129
Tabela. 20 Të dhënat mbi frekuencën dhe përqindjen e vlefshme të grupmohës së pjesëmarrësve.....	130
Tabela. 21 Të dhënat mbi frekuencën dhe përqindjen e vlefshme të edukimit të pjesëmarrësve në studim.....	131

Tabela. 22 Të dhënat mbi perceptimin qytetar në nivelin e ndikimit në politikat e pushtetit qëndror/vendor.....	132
---	-----

LISTA E FIGURAVE

	Faqe
Figura. 1 Burimi: Agjencia e prokurimit publik. Buletini nr.38 datë 26.09.2016.....	77
Figura.2 Burimi: Studimi i Fizibilitetit i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimin e energjisë.....	78
Figura. 3 Burimi: Studim Fizibiliteti. Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë.....	82
Figura. 4 Burimi: WTERT work shop Sofia 2014.....	84
Figura. 5 Burimi: WTERT work shop Sofia 2014.....	84
Figura. 6 Burimi: Vlerësimi i kostos së investimit të inceneratorit Acerra (2010).....	85
Figura. 7 Pasuritë e bashkisë Divjakë para dhënies me qera.....	91
Figura. 8 Grafiku i paraqitjes se objekteve sipas VKB ne m ² Truall dhe Ndertese.....	92
Figura. 9 Te paraqitura grafikisht perberja e ketyre objekteve ne lidhje me truallin.....	93
Figura.10 Te paraqitura grafikisht perberja e ketyre objekteve ne lidhje me ndertesat.....	93
Figura. 11 Grafikisht informacioni ne vite ndermjet Planit, planit te ndryshuar, faktit, debitor.....	106
Figura. 12 Grafiku mbi numrin e objekteve te privatizuara.....	113
Figura. 13 Grafiku i situates aktuale ligjore te objekteve.....	115
Figura. 14 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina Pushimi 13-14 dhe 15-16 Pas.Nr.2/50, 2/51 te cilat jane bashkuar ne Pas.Nr.2/83. Qiramarres Union IDEA.....	118
Figura. 15 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina Pushimi 17-2 Pas.Nr.2/52. Qiramarres Haxhi Murati.....	119
Figura. 16 Emertimi sipas Kartelave financiare, Pallati nr.1. Pas.Nr.2/53. Qiramarres Erjon Bajrami.....	119
Figura.17 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 22-29 Pas.Nr.2/62 Qiramarres A.A.C shpk.....	119
Figura.18 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 62-69 Pas.Nr.2/71 Qiramarres Perparim Maho.....	119
Figura. 19 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 70-73. Pas.Nr.2/72. Qiramarres Hajri Maho.....	120
Figura. 20 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 124-126. Pas.Nr.1-41. Qiramarres Roland Hasko.....	120

Figura. 21 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina Pushimi 1-4 dhe 5-6 Pas.Nr.2/44, 2/45. Qiramarres Apollonia shpk.....	120
Figura. 22 Emertimi sipas Kartelave financiare, PATMOS Pas.Nr.2/54. Qiramarres nuk jane dhen me qira (Bashkia).....	120
Figura. 23 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 38-45 Pas.Nr.2/64. Objekti nuk eshte dhene me qira.....	121
Figura. 24 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 30-37 Pas.Nr.2/65. Objekti nuk eshte dhene me qira.....	121
Figura. 25 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 54-61. Pas.Nr.2/69. Qiramarres Apollonia shpk (prishur kontrata e qirasë.....	121
Figura. 26 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina 46-53. Pas.Nr.2/67 Qiramarres Naun Janko (prishur kontrata e qirasë).....	121
Figura. 27 Emertimi sipas Kartelave financiare, Gabina pushimi. Pas.Nr.1-43. Qiramarres Arben Pambuku (Prishur kontrata e qirasë.....	122
Figura. 28 Gabina Pushimi 7-8, 9-10, dhe 11-12. Pas.Nr.2/47, 2/48, 2/49. Qiramarres Shezai Kuka (Privatizuar).....	122
Figura. 29 Pallati nr.2. Pas.Nr.2/55. Qiramarres Alcoit shpk (Privatizuar)....	122
Figura. 30 Pallati nr.3. Pas.Nr.2/57. Qiramarres Violeta Pandazo (Privatizuar).....	123
Figura. 31 Gabina 24-32. Pas.Nr.2/56.Qiramarres Alcoit shpk (Privatizuar).....	123
Figura. 32 Gabina 89-93. Pas.Nr.2/60. Qiramarres Alcoit shpk (Privatizuar).....	123
Figura. 33 Pasuri e painventarizuar dhe ndodhur mbi pasurinë truall me nr. 2/14 (me emërtimin truall i çadrave në pronësi të bashkisë).....	124
Figura. 34 Pasuri e painventarizuar dhe ndodhur mbi pasurinë truall me nr. 2/14 (me emërtimin truall i çadrave në pronësi të bashkisë).....	124
Figura. 35 Grafiku i pjesëmarrësve sipas gjinisë.....	128
Figura. 36 Grafiku i shpërdarjes së pjesëmarrëse sipa profesionit.....	129
Figura. 37 Grafiku i shpërndarjes së të ardhurave të pjesëmarrësve.....	130
Figura. 38 Grafiku mbi të dhënat e percetimin të impaktit mjedisor.....	135
Figura. 39 Grafiku i perceptimit të dëmtimit të mjedisit nga zbatimi i kontratës.....	135
Figura. 40 Grafiku shembull mbi perceptimin qytetar në rritjen e punësimit dhe kualifikimit të banorëve nga kontrata koncesionare.....	136
Figura. 41 Grafiku i marrëdhënies midis informimit qytetar dhe perceptimit mbi përfitimin ekonomik nga kontrata koncesionare.....	137

LISTA E SHKURTIMEVE

AAGJ	Aktive Afatgjata
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BE	Bashkimi Evropian
BOT	Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ECHR	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FB	Facebook
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ICCP	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
INSTAT	Instituti i Statistikave
KLSH	Konrolli i Lartë i Shtetit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikës e Shqipërisë
LSP	Partneriteti Strategjik Lokal
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
NPV	Vlera Aktuale Neto
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
P.M.M	Plani i Menaxhimit Mjedisor
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PPP	Partneriteti Publik-Privat
SPV	Subjekti për Qëllime të Veçanta
SHBA	Shtetet e bashkuara të Amerikës
UNCITRAL	Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë
UDHR	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Raporti i Monitorimit është përgatitur nga grupi i ekspertëve të projektit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore.

Open Doors dëshiron t'i shprehë mirënjohje kryetareve të Bashkisë Divjakë dhe Fier si dhe antarëve dhe kryetarëve të Këshillit Bashkiak, specialistëve të këtyre bashkive, organizatave lokale të shoqërisë civile të përfshirë në këtë raport monitorimi duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e perkushtuar. Kontributi i tyre bëri të mundur realizmin e objektivave të këtij raporti.

Një falenderim i thellë i shkon institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, specialistëve të tij dhe në veçanci zotit Bujar Leskaj për mbështetjen e tyre dashamirëse dhe profesionale.

Open Doors dëshiron t'i shprehë mirënjohje të veçantë LevizAlbanias për mbështetjen dhe zbatimin e kësaj përpjekte monitoruese dhe advokuese.

LEVIZALBANIA ËSHTË NJË PROJEKT I FINANCUAR NGA SDC (ZYRA ZVICARANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

HYRJE RRETH RAPORTIT TË MONITORIMIT

Ky raport u përgatit nga Qendra “Open Doors” në kuadër të projektit “KONCESCAN” zbatuar gjatë periudhës Maj 2017 – PRILL 2018, me mbështetjen e projektit Lëviz Albania, që ka si synim forcimin e demokracisë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje vendore cilësore.

Objekt i Monitorimit dhe analizës janë 2 kontrata koncesionare / PPP të cilat janë në faza të ndryshme të zbatimit të tyre:

- Ndërtimi dhe Administrimi i impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane në Fier (2016)
- Dhënia me koncensione e 338 kabinave plazhi të Divjakës qeramarrësve të ndryshëm, duke pretenduar në mirëmbajtjen e tyre sipas standardeve të kërkuara nga turistët dhe turizmi (2010)

Raporti bazohet nga njëra anë në monitorimin e investimeve dhe shërbimeve publike të ofruara nga pushteti vendor në Fier dhe Divjake përmes zbatimit të 2 kontratave të mësipërme PPP si dhe analizës së tyre dhe nga ana tjetër matjen e perceptimit publik të komunitetit lokal të këtyre bashkive realizuar nga grupi i ekspertëve të projektit.

Monitorimi shërbeu për të vlerësuar transparencën e procesit, nivelin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje si dhe në konsultimet publike si dhe bën një analizë të perceptimit të komunitetit lokal mbi efektshmërinë dhe dobishmërinë që krijojnë këto kontrata për përmirësimin e jetës së qytetarëve duke përfshirë dimensionet e impaktit social, ekonomik & mjedisor dhe juridik.

Projekti është vijim i punës së Open Doors dhe kontributit të kësaj qendre në zhvillimin e demokracisë vendore dhe qeverisjes së mire në vend, fuqizimit të insitucioneve dhe rritjes së aksesit të publikut e grupeve të tjera të interesit në informacion. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti, synojnë të kontribuojnë si një mjet advokues për marrjen e masave konkrete nga autoritetet përkatëse lokale për rrijen e transparencës, focimin e efektivitetit të përdorimit të infomimit qytetar në nivel vendor si dhe nxitjen e debatit publik.

KAPITULLI I

1.0 TRANSPARENCA E PUSHTETIT VENDOR

1.1 Çfarë përkufizohet me transparencë të pushtetit vendor?

Transparenca e pushtetit vendor gjen përkufizimin në Kodin e Procedurave Administrative, i cili parashikon në dispozita të veçanta¹, të drejtën për t'u informuar. Të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime. E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar. Organi administrativ, që zhvillon procedurën administrative, është i detyruar t'u japë informacion pjesëmarrësve në procedurë edhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Sa më shumë të zbatohet e drejta e informimit nga administrata e pushtetit vendor, aq më shumë transparente janë këto organe.

Përpos Kodit të Procedurave Administrative një rregullim më të zgjeruar ky parim gjen në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Më konkretisht, ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Gjithashtu, ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë². Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës.

¹ Neni 6, Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28 maj 2015 dhe hyn në fuqi një vit pas botimit në Fletoren Zyrtare (neni 189).

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (Ndryshuar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; ligjin nr.9904, datë 21.4.2008; me ligjin nr.88/2012, datë 18.9.2012)

1.2 Çështje të Transparencës në Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore

Në këtë pjesë do të trajtojmë disa çështje të transparencës që parashikohen në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Në kreun VI parashikohet transparenca e organeve të pushtetit vendor, konsultimi dhe pjesëmaërrja qytetare në vendimarrje, në nxerrjen e akteve administrative apo kontratat koncesionare me karakter publik.

Në nenin 15 të ligjit të mësipërm parashikohet transparenca e veprimtarisë së njësisve të vetëqeverisjes vendore. Më konkretisht, njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike. Gjithashtu, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Kurse, në nenin 16 specifikohet konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore, kjo gjithnjë në funksion të transparencës. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Ndërsa, mbledhjet e Këshillit të Bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Procedura parashikon se me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të Këshillit Bashkiak, mbledhjet e Këshillit Bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

Këshilli Bashkiak ose Këshilli i Qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe

organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore³.

Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Gjithnjë në funksion të transparencës neni 19 i ligjit të mësipërm përcakton mundësinë që kanë qytetarët për t'u ankuar nëse nuk zbatohet ky parim nëpërmjet të drejtës për të bërë kërkesë, ankesë dhe vërejtje. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Sa më sipër, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak⁴. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

³ Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”.

⁴ Shih po aty.

KAPITULLI II

2.0 NATYRA E KONTRATAVE KONCESIONARE PËR BASHKITË FIER DHE DIVJAKË

2.1 Çfarë janë kontratat koncesionare?

Përkufizimi i koncesionit varet nga sfera e shkëmbimeve që legjislacioni i një vendi të caktuar përfshin në një marrëdhënie të tillë juridike. Koncesionet janë një nga format e partneritetit publik privat (PPP), por në vende të ndryshme janë zhvilluar regjime të ndryshme ligjore për trajtimin e tyre, për pasojë, në disa legjislacione termi PPP përdoret si term ombrellë për lloje të ndryshme bashkëpunimi midis një enti publik dhe një privati, duke përfshirë këtu dhe marrëdhëniet koncesionare.

Ne mënyrë të përgjithshme koncesioni mund të përkufizohet si autorizimi që i jepet koncesionarit për të investuar në një aktivitet ekonomik që lidhet me dizenjimin, ndërtimin, zhvillimin, rinovimin, transformimin, riparimin, menaxhimin, përdorimin dhe/ose mirëmbajtjen e objekteve infrastrukturore, apo njëren prej këtyre aktiviteteve, ose të ofrojë shërbime publike dhe/ose të menaxhojë pasuri të zotëruara nga shteti. Në këtë marrëdhënie koncesionari merr përsiper riskun e financimit dhe përfundimit të suksesshëm të projektit. Shpërblimi që merr koncesionari konsiston në të ardhurat nga venia në shfrytëzim e projektit, ose të ardhurat nga aktiviteti bashkë me shpërblimin që i paguhet koncesionarit nga autoriteti publik.

Legjislacioni i Bashkimit European i referohet në këtë mënyrë koncesionit: “Koncepti i koncesionit përcaktohet si kontratë e të njëjtit lloj me kontratat publike me përjashtim të faktit që shpërblimi për punën e kryer ose shërbimin e ofruar konsiston vetëm në të drejtën për të shfrytëzuar ndërtimin ose shërbimin, ose në këtë të drejtë bashkë me pagesën.

Ndërsa, legjislacioni kombëtar rregullimin kryesor mbi kontratat koncesionare e bën në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”⁵. Sipas nenit 3 të ligjit të mësipërm “Koncesion” është koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike dhe “Objekti i koncesionit” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruar në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj. Kurse, “Koncesionari” është operatori ekonomik ose subjekti për qëllime të veçanta, me të cilin autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë koncesioni.

⁵ Shënim:(Ndryshuar me ligjin nr. 88/2014, datë 17.7.2014), (Ndryshuar me ligjin nr. 77/2015, datë 16.7.2015).

Sipas ligjit, “Kontratë koncesioni” është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në një rën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë⁶.

Në rastin konkret, në lidhje me dy kontratat koncesionare objekt studimi, fusha e zbatimit të koncesioneve janë dhënë për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme: menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre; prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje; si dhe shërbime sociale. Fusha e zbatimit parashikohet në nenin 4 të ligjit të mësipërm.

2.2 Legjislacioni Shqiptar në fuqi mbi kontratat koncesionare

Për të krijuar një ide të dinamikës ligjore dhe pasojave të saj në investime, po sjellim me poshtë frekuencën e përmirësimeve që i janë bërë kuadrit ligjor mbi koncesionet ndër vite.

Shtylla kryesore e këtij legjislacioni është Ligji 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, i ndryshuar me:

Ligjin nr. 9995, date 22.09.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9663”, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”;

Ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjin nr. 10157, datë 15.10.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar;

Ligjin nr. 10281, date 20.5.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 05.05.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar;

Në zbatim të ligjit në fjalë u miratua me Vendim të Keshillit të Ministrave “Rregullat për koncesionet” VKM Nr. 27, datë 19.1.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion”;

-VKM Nr. 575, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/Partneritet Publik Privat”;

⁶ Shih Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”

-VKM Nr. 576, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet”;

-VKM Nr. 634, datë 1.10.2014, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/Partneritet Publik Privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, ndryshuar;

-VKM Nr. 150, datë “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), ndryshuar;

Gjithashtu, dhe VKM e mëposhtme plotësuan kuadrin ligjor të funksionimit të koncesioneve: V.K.M. nr. III, date 09.03.2007 “Për krijimin e grupeve të punës për identifikimin dhe dhënien me koncesion”.

VKM nr. 469, date 16.06.2010 Për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, ndryshuar me,

V.K.M nr. 121, datë 22.2.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 469, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave”.

Sa më sipër, legjislacioni shqiptar mbi koncesionet krijon një bazë të mirë për trajtimin në mënyrë transparente të projekteve të bashkëinvestimit të organeve publike dhe përmbush standardet ndërkombëtare të vendosura për këtë sferë nga organizma autoritative si UNCITRAL, OECD apo EBRD, por zbatimi në praktikë de facto krijon një hendek të madh nga rregulli i shkruar.

2.3 Veçantitë e kontratave koncesionare për dy bashkitë në shyqërtim

Ndërtimi dhe Administrimi i impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane në Fier (2016)

Së pari duhet të theksojmë faktin se, problematika e menaxhimit të mbetjeve në qarkun e Fierit është e mbartur prej shumë vitesh duke krijuar kështu një problem kompleks, zgjidhja e të cilit përveç vullnetit të mirë të Bashkisë, kërkonte edhe investime të konsiderueshme. Në kushtet kur Bashkia Fier nuk disponon burimet financiare të nevojshme, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit për zgjidhjen e problematikës. Sa më sipër, theksojmë që kontrata është në nivel ministrie dhe nuk është vetëm pushteti vendor që ka kompetencë për zbatimin e saj, por kryesisht pushteti qendror.

Së dyti, objektivi i projektit është përpunimi i mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit, gjenerimi i energjisë dhe krijimi i vend depozitimit të mbetjeve me objektivat e mëposhtëm:

1. Ndërtimi gjatë viteve 2016-2017 dhe vënia në përdorim në vitin 2018 e Impiantit të përpunimit dhe venddepozitimit të mbetjeve urbane për Qarkun e Fierit;
2. Krijimi i Energjisë së rinovueshme nga përpunimi i ketyre mbetjeve;
3. Ruajtje e ambjentit të kesaj zone përmes rritjes së cilësisë së ajrit, pastrimin e ambjentit dhe eleminimin e ndotjeve të ujrave sipërfaqesor dhe nëntokesor për këtë zonë;
4. Krijimin e vendeve të reja të punës për banoret e kësaj zone.

Sipas objektivave të marrë përsipër nga autoritetet, implementimi i këtij projekti do të fillojë në vitin 2016, impianti do të vihet në punë në fillim të vitit 2018, ndërsa vend depozitimi (landfilli) fillon funksionimin e tij në tetë mujorin e parë të vitit 2016. Me vënien në punë të këtij impianti pritet që të përpunohen rreth 180-200 ton mbeturina urbane në ditë ose rreth 70,000 ton/vit.

Kontrata e Konçesionit “Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë” është e formës BOT, në lidhje me financimin, projektimit, ndërtimin, vëniën në punë, administrimin, menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme urbane dhe impiantin, mirëmbajten e landfill-it, dhe prodhimin e energjise elektrike, e lidhur në vitin 2016 ndërmjet Mnistrisë së Mjedisit, (referuar si “Autoriteti Kontraktues”) i përcaktuar si i tillë referuar ligjit nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat” dhe Konçesionarit. Kjo kontratë është e bazuar në Ligjin nr. 125/2013, dt. 18.12.2006 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.575, datë 10.07.2013, “Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik/privat”; i ndryshuar. Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011; “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, “Për vetqeverisjes vendore”; Ligji 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar; Ligji 10448/2011 “Për lejet dhe licencat” të ndryshuar; Ligji nr.8752, datë 23.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar; Ligji nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligji “Për menaxhimin e integruar të ujerave”; Ligjit nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e

huaja”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.07.2011 “Për lëndfillin e mbetjeve” etj. ;

Sipas kësaj kontrate termi “Kontratë Koncesioni” ose “Kontratë”, do të thotë kjo kontratë e shkruar e lidhur mes Palëve përfshirë Dokumentat Standarte të shpallura nga Autoriteti Kontraktues, Ofertën e Koncesionarit, të gjitha Anekset dhe Formularët dhe dokumentat bashkëngjitur, të cilët përbëjnë pjesë integrale dhe të pandashme të saj pavarësisht emërtimeve që u jepen në vijim të negociatave mes Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, kurse, “Lëndfill” do të thotë fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lëndfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit.

Ndërkohë neni 1 i kësaj kontrate në objektin e saj parashikon që Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet kësaj kontrate dhe në përputhje me kushtet e saj, i jep Koncesionarit të drejtën për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë të impiantit, administrimin, menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane jo të rrezikshme dhe mirëmbajtjes së lëndfill-it, grumbullimit dhe përdorimit të mbetjeve për prodhimin e energjisë elektrike dhe transferimi në fund të periudhës koncesionare nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, të impiantit të incenerimit. Ndërkohë, po sipas kësaj dispozite parashikohet që rregullimi i marrëdhënieve mes Autoritetit Kontraktues dhe koncesionarit lidhet me marrjen në dorëzim të terreneve mbi të cilat do të ngrihet impianti dhe transferimin në përfundim të koncesionit tek Autoriteti Kontraktues; kryerjen e punimeve për përgatitjen dhe vënien në siguri të zonës së kantierit për fazat e mëtejshme të realizimit të veprës; realizimin e gjithë punimeve të nevojshme për depozitimin e mbetjeve jo të rrezikshme të ardhura nga të gjithë bashkitë që bëjnë pjesë në Qarkun e Fierit; operimin e impiantit për 6 (gjashtë) vjet.

Me rëndësi është që të pasqyrojmë në këtë raport të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit, i cili duhet të kryej detyrimet si më poshtë; të marrë në dorëzim zonën e përcaktuar bazuar në nenin 2 të kësaj kontrate; të kryejë punimet e vënies në siguri të zonës për përgatitjen e kantierit, me detyra dhe përgjegjësi në ngarkim të vet; do të krijojë infrastrukturën e nevojshme për depozitimin e mbetjeve; do të kryejë, në përfundim të operimit të impiantit. Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë do të krijojë një sistem menaxhimi mbetjesh, që do të ndihmojë në

reduktimin e mbetjeve që do të depozitohen në lëndfill dhe në arritjen e objektivave kombëtare të caktuar nga Strategjia dhe Plani Kombëtar i menaxhimit të mbetjeve brenda kufijve teknikë të projektit; do të organizojë procesin e grumbullimit, trajtimit dhe transportit të mbetjeve brenda territorit të impjantit; do të krijojë një ambient që nxit arritjen e objektivave për riciklim etj .

Krahas të drejtave të Koncesionarit të shprehura në objektin e kësaj kontrate dhe në përmbajtje të ligjeve në fuqi, një nga rastet që koncesionari ka të drejtë të zgjidhe këtë kontratë është nga pamundësia e koncesionarit për të lidhur kontrata me Bashkinë e Qarkut Fier, për shkak të mungesës së këtyre të fundit për këtë qëllim dhe pavarësisht përpjekjeve dhe/ose ndërmjetësimit të Autoritetit Kontraktues në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, pala tjetër kontraktore Ministria e Mjedisit ka të drejtat dhe detyrimet e saj të cilat po i theksojmë si më poshtë: Autoriteti Kontraktues merr përsipër të asistojë Koncesionarin në marrjen e lejeve, licencave dhe të autorizimeve të nevojshme, përfshirë edhe shpronësimin, për ndërtimin e impjantit dhe menaxhimin e tij; merr përsipër të monitorojë punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga Koncesionari, kushtet dhe masën, në të cilën Autoriteti Kontraktues mund për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit duke u bazuar në dokumentet standarte të procedurës konkurruese, ofertën e koncesionarit dhe ligjin në fuqi, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën të marrë masa të tjera të arsyeshme, për të siguruar që infrastruktura të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuale, si dhe ka të drejtën për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to, etj .

Punimet për vënien në siguri të vendit të kantierit dhe ndërtimit të impjantit duhet të kryhen në përputhje me ligjet në fuqi dhe projektin e miratuar gjatë procedurës konkurruese. Sipas kontratës, Koncesionari merr përsipër të realizojë ndërtimin e impjantit brenda 24 muajve nga data e fillimit të punimeve si dhe është i detyruar të respektojë, normat dhe standratet kombëtare në lidhje me menaxhimin e këtij shërbimi të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi dhe kushtet e lejes së dhënë. Për më tepër, Koncesionari duhet të mbajë në lëndfill dhe të plotësojë regjistrat e ngarkimit dhe shkarkimit të mbetjeve në përputhje me parashikimet ligjore, si edhe duke i regjistruar në version elektronik dhe duke ia përcjellë Autoritetit Kontraktues. Përbëjnë shkak për zgjidhje të kësaj kontrate edhe rastet në cilat koncesionari

do të ishte përgjegjës për shkelje të rënda të ligjeve apo në realizimin e punimeve për vënien në siguri dhe të sistemeve plotësuese të monitorimit mjedisor apo të mospërmbushjeve të tjera të konsiderueshme dhe të përsëritura të detyrimeve të marra përsipër me këtë kontrate .

Qeveria Shqiptare ka vendosur t'i djegë plehrat në vend që t'i riciklojë ato, vendim që bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar të menaxhimit të mbetjeve, shumëfishon kostot dhe rrit rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve. Ky incenerator bie ndesh me planin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të miratuar nga qeveria shqiptare, i cili i jep përparësi parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit përpara asgjësimit të mbetjeve, dhe parashikon trajtimin e tyre nëpërmjet landfildeve. Ekspertët dhe aktivistët mjedisorë paralajmërojnë se duke i dhënë përparësi inceneratorëve kundrejt trajtimit të mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe depozitimit, qeveria po shumëfishon kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane, ndërkohë që nënvizojnë që incenerimi është një proces që prodhon gazra të rrezikshëm kancerogjen dhe Shqipëria nuk ka kapacitetin e duhur institucional për të monitoruar normat e shkarkimeve .

Shqipëria është një nga vendet me menaxhimin më të keq të mbetjeve në rajon dhe situata paraqitet alarmante në të gjithë vendin, por nuk mund të themi të njëjtën gjë në aspektin ligjor, pasi legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, të cilat i për afrohen standardeve të Bashkimit Evropian. Megjithatë, debati për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri vendos përballë njëri-tjetrit dy fakte kontradiktore. Nga njëra anë legjislacioni shqiptar mbështet riciklimin, me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe nga ana tjetër qeveria Shqiptare, e cila ka marrë përsipër ngritjen e tre incineratorëve, duke parë si zgjidhje asgjësimin e mbetjeve. Legjislacioni shqiptar i jep përparësi menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke ndjekur një hierarki të qartë që fillon me parandalimin, ripërdorimin, riciklimin dhe vetëm si mundësi të fundit, asgjësimin që mund të kryhet nëpërmjet incineratorëve. Sipas planit të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025, të draftuar dhe miratuar nga qeveria shqiptare me ndihmën e Bashkimit Evropian, deri në vitin 2020 Shqipëria duhet të ndërtojë 12 landfilde inxhinierike për grumbullimin e mbetjeve bashkiake sipas standardeve të BE-së. Sipas ekspertëve të mjedisit, vendimi i qeverisë për të injoruar planin e menaxhimit të mbetjeve në favor të ndërtimit të incineratorëve për djegien nuk mbështet në ligj. Incenerimi është forma e fundit e parashikuar nga plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve, por e para për sa i përket kostos së trajtimit të tyre, më e shtrenjtë nga të gjitha format e tjera të paraqitura në piramidën e përpunimit të mbetjeve. Incineratorët që prodhojnë energji janë të kushtueshëm si për t'u ndërtuar, por edhe për t'u menaxhuar dhe

kompanitë shpesh e kompensojnë këtë duke negociuar kontrata afatgjata me bashkitë dhe në skenarin e Shqipërisë, me qeverinë direkt.

Në krahasim me inceneratorët landfillet janë më të lirë për t'u ndërtuar dhe kanë një kosto më të ulët operimi. Trajtimi mbetjeve nëpërmjet kompostimit në landfille, shihet si një alternativë më e sigurt edhe nga ekologjistët.

Sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave, pranë Ministrisë së Mjedisit, z Pëllumb Abeshi incinerimi është një teknologji që përmban procesin e riciklimit, kompostimit dhe prodhimit të biogazit dhe pjesa e mbetjeve që mbeten, digjen. Sipas z. Abeshi të gjitha këto procese janë pjesë e teknologjive të miratuara tashmë për Elbasanin, Fierin dhe Tiranën. Nga ana tjetër, ekologjistë dhe ekspertë të fushës mendojnë të kundërtën, ata thonë se procesi i incinerimit shkatërron materialet e riciklueshme dhe kompostuese. Megjithëse në Evropë aplikohet në masë metoda e incinerimit si proces i fundit për zvogëlimin e volumit të mbetjeve të pariciklueshme, faktet tregojnë se i jepet një rëndësi shumë e madhe ndarjes së mbetjeve në bazë dhe riciklimit të tyre. Në shumë vende në Evropë, pjesa më e madhe të mbetjeve të gjeneruara riciklohet dhe më pas kompostohet në landfille. Ky proces realizohet në masë 66% në Gjermani , Austria 57%, Sllovenia 54%, Zvicra dhe Belgjika 53% dhe Holanda 52%

Ekspertë kombëtar dhe ndërkombëtarë e mbështesin ligjin shqiptar dhe janë për aplikimin e metodës “Zero Mbetje”, e cila kërkon të ripërdorë të gjitha produktet dhe mundësisht të mos dërgojë asgjë për djegie. Sipas praktikave europiane në këtë fushë “Zero Mbetje” nënkupton trajtimin e produkteve, nënkupton proceset që zvogëlojnë vëllimin dhe toksicitetin e mbeturinave dhe materialeve, ruajtjen dhe rikuperimin e të gjitha burimeve dhe jo djegien ose varrosjen e tyre. Ka shumë organizata ndërkombëtare që mbështesin fuqishëm metodën “Zero Mbetje” përfshirë grupe të tilla si Zero Mbetje Evropë, Aleanca Globale për Alternativat e Incineratorit, Rrjeti i Drejtësisë së Energjisë, të cilat janë bërë kundërshtarë të zjarrit të teknologjisë së incinerimit, duke pretenduar se djegia dështon kur bëhet fjalë për përfitimin real të energjisë, dhe në të vërtetë inkurajon mbetjet. Ka shumë qytete në mbarë botën, të cilat kanë përqafuar metodën “Zero Mbetje” dhe kanë gjetur zgjidhje të menaxhimit të mbetjeve që nuk janë ndotëse, që janë të orientuara nga komuniteti, përfshirëse, më pak të shtrenjta dhe miqësore ndaj klimës.

Në monitorimin e kryer mbi kontratën e mësipërme u konstatuan një sërë shkeljesh ligjore.

1. Më konkretisht nëpërmjet shkresës “Kërkesë për informacion” datë 7.10.2017 qendra “Open Doors” me qëllim advokimin, monitorimin e zbatimit ligjor të kontratës i është drejtuar Ministrisë së Mjedisit në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe nenit 6 të Ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003, FZ nr. 66 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” duke kërkuar vënien në dispozicion një kopje të dosjes së plotë të zbatimit të kontratës koncesionare me qëllim që të evidentonte shkeljet ligjore për rastin konkret. Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik nga Ministria e Mjedisit ashtu edhe Bashkia Fier, nëpërmjet një ankese iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit, për ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhenies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Autoriteti Publik nuk përmbushi detyrimet e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Bazuar në nenin 15 të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë punë nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar, çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit.

Për sa më sipër konstatohet se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin për të informuar kerkuesin në kohën e duhur. Ky informacion u vu në dispozicion i pjeshëm përtej afatit 2 mujor.

Sa më sipër, është shkelur në mënyrë flagrante nga Autoriteti Publik, Bashkia Fier si dhe Ministria e Mjedisit, Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 6, Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më konkretisht parimi i transparencës. Jo pa qëllim mbi 55 % e subjekteve pjesëmarrës në anketim e konsiderojnë bashkinë aspak ose pak transparente në lidhje informacionet që ka dhënë mbi kontratat koncesionare ku të dhënat tregojnë se perceptimi publik mbi rolin e dëgjësave publike, medias dhe faqes zyrtare/FB së Bashkisë është i ulët si dhe qytetarët janë pak të informuar mbi anët pozitive dhe negative të kontratës.

Nga të dhënat e sondazhit rezulton se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve janë aspak, pak dhe disi të kënaqur me qëndrimin e Bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare duke vënë në dukje frikën që pjesëmarrësit kanë në lidhje me abuzimet ligjore mbi kontratën koncesionare për shkak se pushtetarët në përgjithësi abuzojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ligjin.

2. Duhet të theksojmë faktin se, incenerimi zbatohet prej shteteve të industrializuara, qeveritë e të cilave kanë kapacitete të larta kontrolluese dhe aftësi të trajtimit të mbetjeve. Në Fier njerëzit u rebeluan. Autoritetet janë tërhequr dhe inceneratori nuk ka filluar ende të ndërtohet. Natyrisht, përkohësisht.
3. Nga hulumtimi rezulton se zona e përzgjedhur ndodhet pranë zonës urbane dhe ky është një risk shumë i madh për banorët që ndodhen rreth impantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier, me pasoja shëndetësore duke çënuar në mënyrë thelbësore jetën e tyre.
4. Një faktor që rezulton si vendimtar në formimin e perceptimit dhe opinionit publik mbi këtë kontratë koncesionare, është përfshirja dhe angazhimi i komunitetit në dëgjesa publike.
5. Konstatohet se në Bashkinë e Fierit, mungon informimi për qytetarët të cilët duhen të orientohen nëpërmjet tabelave ku mund të marrin informacionin që ju duhet pasi faqja e internetit nuk është e përditësuar pasi bashkia nuk e ofron informacionin e kategorizuar që të jetë lehtësisht i kërkueshëm për qytetarët. Bashkia duhet të zbatojë ligjin për konsultimin publik. Të gjithë qytetarët duhet të lajmërohen kur realizohen takime/konsultime publike. Qytetarët kanë akses të kufizuar në informacione dhe shumë pak prej tyre e dinë që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për ta. Bashkia duhet të gjejë mekanizma së bashku me OSHC-të me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Qytetarët e sondazhuar shprehen se kanë vështiresi në marrjen e informacionit, në mjaft raste ata shprehen se nuk dinë ku të drejtohen për të marrë të dhënat, duke i kërkuar informacion ose takim në mënyrë të drejtëpërdrejtë titullarit të institucionit, sepse stafi i institucionit është arrogant ose nuk të ofron një informacion të plotë.
6. Një shkelje tjetër ligjore e Bashkisë Fier është sepse në rastin konkret nuk është bërë që në fillim një studim i mirëfilltë për zgjedhjen e sheshit se ku do të vendosjej inceneratori dhe jo pa shkak banorët me të drejtë në dy raste nuk kanë pranuar që kjo vepër të ndërtohej afër zonave ku ata banonin duke protestuar. Ky është një nga shkaqet kryesore të përplasjeve midis palëve kontraktore dhe qytetarëve që duhet të

ishin zgjidhur që në momentin e kryerjes së këtij studimi, i cili duhet të ishte i diskutueshëm me çdo banor.

7. Gjithashtu, nga një pjesë e konsiderueshme e mediave shqiptare është publikuar fakti se kompania fituese koncesionare e riciklimit të plehrave në Fier, është regjistruar për këtë shërbim 15 ditë pas shpalljes së tenderit, fakt ky i konstatuar nga studimi. Sipas akteve më datë 13.07.2016 është hapur tenderi për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier. Më datë 28.07. 2016 kompania fituese e tenderit “Integrated Technology Services” e regjistruar për aktivitet në fushën e Teknologjise së Informacionit shton në objektin e aktivitetit të saj edhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve me djegie (Incenerator) dhe landfille për përpunimin e mbetjeve urbane dhe të rrezikshme. Me 15.09.2016 njoftohet se një bashkim operatorësh ndërmjet kësaj kompanie shqiptare “Integrated Technology Services”, me administrator dhe ortak të vetëm Klodian Zoto e njohur si kompani IT-e dhe shoqërisë italiane “Energy 2SRL” e specializuar në “Green Energy”, pa lidhje me riciklimin, kanë fituar garën për kontratën koncesionare me një afat 6 vjeçar. Gjithçka është bërë pa transparence me publikun dhe në mënyrë shumë të shpejtë.
8. Jo rastësisht nga të dhënat e sondazhit rezulton se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve janë disi të kënaqur me qëndrimin e Bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare duke e parë atë jo transparent si dhe duke patur frikë nga ndotja e mjedisit që mund të vijë nga moszbatimi i standarteve nga Autoriteti Publik dhe Koncesionari.
9. Çështjet kryesore që i referohen veçantisë së kontratës koncesionare në rastin e Bashkisë së Fierit e lidhur me ndërtimin dhe administrimin e impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane, fokusohen rreth këtyre problematikave kryesore si situata e informimit të qytetarëve, prezantim nga specialistët mjedisor dhe ekspertë të tjerë mbi avantazhet dhe disavantazhet e kesaj kontrate kryesisht në impaktin mjedisor të saj, përfshirja dhe roli i mediave të ndryshme në këtë proces, përfitimet e mundshme ekonomike nga kontrata për bashkinë dhe komunitetin. Të gjitha këto tema u parashtruan gjatë diskutimeve në fokus grup ku pjesëmarrës të ndryshëm hodhën këndvështrimet e tyre më në detaje dhe thellësi mbi ndikimin pozitiv dhe negativ të secilës në nivelin e informimit dhe perceptimin e pjesëmarrësve nga komuniteti mbi këtë kontratë specifike koncesionare.

10. Një faktor që rezulton si vendimtar në formimin e perceptimit dhe opinionit publik mbi këtë kontratë koncensionare, është përfshira dhe angazhimi i komunitetit në dëgjesa publike. Nga të dhënat e studimit rezulton se është shkelur hapur Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” duke i lënë qytetarët jashtë dikutimit në lidhje me vendimarrjen në këto kushte, lind nevoja që organizimi i dëgjesave publike të jetë i herë pas hershëm dhe jo përqëndruar në vetëm disa takime të rralla në kohë, më konkretisht në çdo rast që ka vendimarrje dhe këto dëgjesa publike duhen njoftuar në kohën e përshtatshme me qëllim që të gjithë anëtarët e interesuar të komunitetit të gjejnë hapësira për të qene prezent në to. Është i rëndësishëm fakti që informacioni për publikun sidomos në lidhje me këto kontrata konçesionare, të cilat janë të ndërlikuara me terma juridikë duhet të jetë të plota dhe të kuptueshme nga i gjithë publiku panvarësisht nivelit arsimor të tyre. Ky informacion gjithashtu, duhet të transmetohet me aspektet positive dhe negative të tij, duke bërë të mundur në këtë formë eliminimin e pikëpyetjeve duke mos lënë vend për keqinterpretim. Jo pa qëllim banorët e Portëz që kishin zero informacion dhe transparencë protestuan dhe ishin ata që mendonin se ladhfilli do të ngrihej afër shtëpive të tyre pasi nuk kishin asnjë informacion të saktë, madje kishin një mori informacionesh nga më të ndryshmet dhe kontradiktore. Për më tepër, edhe nga informacionet e hulumtuara në mediat kombëtare rezulton se ekspertët e mjedisit shprehen pesimistë për ndërtimin e kësaj veprë, e cila është e parakohshme në kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria.

Dhënia me koncensione e 338 kabinave plazhi të Divjakës qeramarrësve të ndryshëm, duke pretenduar në mirëmbajtjen e tyre sipas standardeve të kërkuara nga turistët dhe turizmit (2010)

Në Bashkinë Divjakë me kontratën koncesinare preket një problematikë e hershme që i referohet vitit 2010. Më konkretisht, bëhet fjalë për dhënien me koncension të 338 kabinave të plazhit të Divjakës tek qeramarrës të ndryshëm, duke pretenduar në mirëmbajtjen dhe rritjen e standardeve në shërbimin ndaj turistëve. Nga hulumtimi i “Open Doors” në këtë kontratë vihen re një sërë abuzimesh ligjore që po rendisim si më poshtë:

1. Nga shkresa e datës 26.10.2017, me lëndë “Kthim përgjigje”, nga Zyra e Prokurimeve Bashkia Divjakë, drejtuar “Open Doors” rezulton mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” realizimi i të ardhurave për Bashkinë

Divjakë, për periudhën nga momenti i lidhjes së kontratave deri më sot për objektet e dhëna me qera, (Kabina Plazhi lidhur në 2010), realizimi i të ardhurave sipas përcaktimit të saktë të marrë nga zyra e Tatim Taksave dhe Auditimit të Brendshëm më konkretisht edhe me rekomandimin e KLSH-së është në vlerën 12,462.962 lekë . Ndërkohë, sipas shkresës së mësipërme për marrjen e masave në rrugë ligjore për ato subjekte që nuk paguajnë nga Bashkia Divjakë është dërguar njoftimi për prishjen e Kontratës së Qirasë dhe marrjen në dorëzim të Kabinave nga ana e Bashkisë Divjakë.

2. Bashkia Divjake e ka dhënë me qira një sërë pasurish që janë ekskluzivisht nën administrimin e pushtetit vendor. Të gjitha këto pasuri, e të tjera, janë të regjistruara në ZVRPP Lushnjë si pronë e Bashkisë Divjakë pasi janë transferuar në pronësi të Bashkisë Divjakë me Vendimin nr. 499, date 19.07.2006 të Këshillit të Ministrave, pra, janë prona ekskluzivisht të Bashkisë Divjakë dhe në këtë mënyrë është atribut i Këshillit të Bashkisë Divjakë, për tjetërsimin ose jo të tyre, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe jo i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, siç është vepruar në rastin konkret. Sa më sipër, është një abuzim i rëndë që është bërë duke tjetërsuar këto prona të Bashkisë Divjakë, pa dijeninë e saj, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe subjektet përfituese. Palë në këtë abuzim është bërë edhe noterja Drita Pepi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, e cila ka përpiluar kontratat e shitjes së pasurive të sipërpërmendura, duke kryer një sërë shkeljesh ligjore në to, me anë të cilave i ka sjellë një dëm shumë të rëndë interesave të Bashkisë Divjakë. Në të gjitha kontratat e shitjes të pasurive të sipërcituara (nr. 3043 rep, nr. 1137 kol, datë 10.09.2013 ; nr. 3044 rep, nr. 1138 kol, datë 10.09.2013; nr. 3045 rep, nr. 1139 kol, datë 10.09.2013 ; nr. 3046 rep, nr. 1140 kol, datë 10.09.2013), të redaktuara prej noteres, nuk është kërkuar dokumenti pronësisë (çertifikatë pronësie apo vërtetim pronësie), veprim të cilin vetë noteri e ka pranuar në nenin 9 të secilës prej kontratave, ku dokumenti i pronësisë i pasurive objekt shitje nuk është pjesë e asnjërës prej kontratave, veprim që vjen në kundërshtim me nenin 54 të ligjit nr. 7829, dt.01.06.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar, pasi noteri ka për detyrim ti kërkojë palëve dokumentin e pronësisë, i cili është thelbësor në kryerjen e një transaksioni dhe t’i identifikojë ato. Si pasojë e kësaj shkelje, noteri, duke mos pasur mundësinë se kush është pronari i vërtetë i këtyre pasurive (sipas dokumenteve të pronësisë që posedon Bashkia Divjakë), ka gabuar rëndë duke mos e përmendur në asnjë paragraf të kontratës Bashkinë Divjakë në rolin e pronarit, por është mjaftuar të përmendë që

prona e ka vendndodhjen në Divjake, gjithashtu duke mos pasur në dispozicion një dokument pronësie, noteri ka gabuar përsëri në percaktimin e kufijve, pasi në të gjitha vërtetimet e pronësisë që posedon Bashkia Divjakë për këto prona, në asnjë prej tyre nuk përputhen kufitarët me ata që ka përmendur noteri në kontratat e shitjes të lartpërmendur.

3. Nga hulumtimi i dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nga Bashkia Divjakë rezulton se i janë drejtuar një sërë shkresash institucioneve përkatëse me qëllim mosprivatizimin e këtyre objekteve, pasi për këto zone “zona e plazhit Divjake” nuk ka ende një plan urbanistik të miratuar nga KRRTRSH-ja në të cilin mund të parashikoheshin objekte të ndryshme (rruge, kend lojrash etj) dhe deri në miratimin e një plani urbanistik të përgjithshëm është kërkuar pezullimi i të gjitha veprimeve për privatizim për të gjitha objektet në zonen e plazhit Divjakë, por si përfundim në kundërshtim me ligjin është kryer privatizimi i këtyre objekteve. Për më tepër, sipas anketimit shumë nga kabinat janë marrë me qera nga njerëz që nuk janë nga Divjaka, por nga Durrësi, Lushnja etj, dhe gjithçka është bërë në fshehtësi të plotë, kurse banorëve të Divjakës u janë ofruar ti merrnin me qera me një cmim më të lartë sesa banorëve të Lushnjës .
4. Nga informacioni që kemi marrë nga Bashkia Divjakë rezulton se në lidhje me katër gabinat e plazhit, të cilat janë tjetërsuar në mënyrë të paligjshme nuk ka patur asnjë lloj transparence apo shpallje publike me qëllim informimin e publikut në lidhje me këtë vendimarrje. Sipas bashkisë procedura e dhënies me qera dhe privatizimi i disa kabinave të plazhit në Divjakë shihet si i realizuar në mënyrë të pa ligjshme nga pushteti i vjetër vendor dhe për këtë situatë konsiderohet si një shkelje flagrante që meriton të gjejë zgjidhje në Gjykatën Administrative, duke theksuar se, të gjithë ata që kanë marrë kabinat janë njerëz me pushtet që kanë abuzuar me kontratat.
5. Gjithashtu, burime nga Bashkia Divjakë konfirmon faktin se, banorët e Divjakës janë diskriminuar në krahasim me banorë të qyteteve të tjera përreth, duke u ofruar kosto më të lartë shërbimi në lidhje me përdorimin e kabinave të plazhit. Sa më sipër ky është një diskriminim për shkaqe sociale apo krahinore duke shkelur hapur nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bashkia pohon se ka patur shumë abuzime në lidhje me çmimet dhe problemi qëndron tek keqpërdorimi i pushtetit të Bashkisë e zgjedhur në mandatin e mëpërshëm.
6. Nga informacioni zyrtar i Bashkisë Divjakë rezulton se katër qeramërrësit e kabinave Divjakë që më pas në kundërshtim me ligjin kanë privatizuar këto objekte, janë

debitorë kundrejt bashkisë duke mos shlyer një pjesë të detyrimeve të akumuluarra në vite.

7. Aktualisht Bashkia Divjakë nuk ka mundur dot që të vendosë në vend të drejtën ligjore të shkelur duke ju drejtuar gjykatës kompetente, jo vetëm që nuk ka arritur dot që të mbledhë një pjesë të detyrimeve të pashlyera nga qiradhënia e kabinave të plazhit, por as ka mundur dot që ngrejë një padi duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratave të shitjes së gabinave si dhe zgjidhjen e pasojave në lidhje me rastin konkret. Bashkia Divjakë konfirmon faktin se aktualisht është duke iu nënshtuar një auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe pas përfundimit të raportit të këtij institucioni do të vendosë se çfarë do të bëjë në lidhje me problematikat ligjore që evidentohen në rastin e kabinave të plazhit Divjakë. Por ky argument nuk është i mbështetur në ligj si dhe nuk justifikon dot neglizhencën e dukshme edhe nga Bashkia aktuale Divjakë.
8. Bashkia Divjakë vlerëson se është e nevojshme që kjo problematikë të publikohet edhe në media, veçanërisht në televizione me shikueshmëri të lartë, me qëllim për të sensibilizuar qytetarët se si është bërë tjetërsimi i paligjshëm i disa kabinave të plazhit, sa janë çmimet e përdorimit të tyre apo mundësitë dhe aksesit që duhet të ketë çdo qytetar në përdorimin e tyre, për më tepër, banorët e zonës ku ato ndodhen. Jo pa qëllim nga anketimi rezulton se, përfaqësues të komunitetit e vënë theksin tek natyra informale e informimit mbi kontratat duke u preferuar përcjellja gojë më gojë mes qytetarëve dhe jo me instrumenta si lajmërimet, njoftimet, afishimet, faqe interneti, FB ose media. Pas shumë vitesh qeradhënie të kabinave të plazhit në Divjakë opinionin i komunitetit gjendet i pa informuar për ndryshimet.
9. Duhet marrë masa për shfrytëzimin eficient të Kabinave të Plazhit me qëllim që efekti i përfitimeve ekonomike të zgjerohet më tej tek biznesi tjetër i zonës dhe popullsia lokale. Efekti ekonomik vihet re gjatë verës kur vijnë pushues që i përdorin ato ose i marrin me qera nga ata që i kanë. Sot 80 % e gabinave janë investuar nga ata që i kanë marrë me qera ndërsa tek 20 % tjetër nuk është vënë dorë dhe janë të rrënuar. Në kabinat e rrënuara Bashkia Divjakë duhet të ndërhyjë menjëherë duke mundësuar restaurimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëpashme për të qenë të shfrytëzueshme në maksimum.
10. Kontrolli i Lartë i Shtetit është vënë menjëherë në lëvizje pas kërkesës së “Open Doors” dhe nëpërmjet shkresës Nr. 1104/3 Prot. datë 30.12.2017 me lëndë “Kthim përgjigje mbi rezultatet e auditimit” informon se në përgjigje të kërkesës tuaj datë

18.10.2017, administruar nga KLSH me nr. 1104, datë 23.10.2017, lidhur me “Dhënien me qira të kabinave të plazhit, arkëtimin e vlerës së qirave, privatizimin e disave prej tyre, etj”, dhe vijim të korrespondencës të krijuar për këtë qëllim, KLSH me autorizim të Kryetarit të KLSH-së me nr. 1104/2, datë 02.11.2017, ushtrij auditim tematik, (dokumentar dhe atij në terren mbi statusin faktik të objekteve/kabinave të plazhit), përsa i përket kërkesave të Qendrës Open Doors.

Rezultat e auditimit janë bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit, dhe konkretisht janë trajtuar në pikën nr. 9 “Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit kërkesë/ankesa e Open Doors”, (faqet nr. 254-284), raport i miratuar me Vendimin nr. 179, datë 20.12.2017 të Kryetarit të KLSH, si dhe për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 779/11, datë 20.12.2017, “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet për Auditimin “Përputhshmërie dhe rregullshmërie”, është rekomanduar Kryetari i Bashkisë Divjakë, për zbatimin e masave duke u rekomanduar 3 masa me karakter organizativ (masa me nr. 8, 12 dhe 13) dhe 1 masë me karakter shpërbllim dëmi (masa me nr. 14), bashkëlidhur kësaj shkrese, pjesa takuese e raportit dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës dhe rregullimin e pasojave.

Lidhur me privatizimin e objekteve e trojeve të dhëna me qira, ka rezultuar se, për 6 kontrata qiraje ka rezultuar se në vitin 2013, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Privatizimit, është kryer procesi i privatizimi të tyre. Shitja e pasurive nga METE, është kryer në kushtet kur personi juridik i cili ka atributet ligjore për vlerësimin dhe miratimin e çdo forme të tjetërsimit të tyre pra Këshilli i Bashkisë Divjakë, nuk ka dhënë miratimin/pëlqimin për privatizim nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Bashkia Divjakë është shprehur sistematikisht se në cilësinë e pronarit të objekteve dhe trojeve të tyre nuk është dakord për privatizimin e tyre nga subjektet e interesuara. METE, është referuar në VKB nr. 13, datë 11.02.2008, por pa kërkuar pëlqimin aktual të Bashkisë, sikundër përcaktohet nga VKM nr. 428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”. VKB nr. 13, datë 11.02.2008, ka qenë edhe më parë objekt shqyrtimi e auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vitin 2013, ku në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet KLSH është shprehur se:...Këto pasuri janë dhënë me qira nga Bashkia Divjakë gjatë vitit 2010 dhe fillimit të vitit 2011, kështu që këto vendime në lidhje me këto pasuri konsiderohen të ezauruara, pasi miratojnë vetëm njërin nga veprimet, tjetërsimin ose dhënien me qira. Nga dokumentacioni që ka mundur të

administrojë Bashkia Divjakë, lidhur me privatizimin e objekteve e trojeve, konstatohet se në asnjë procedurë nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i pronarit, edhe pse sipas shkresës të METE, për ngritjen e komisionit të vlerësimit është caktuar si përfaqësues i këtij institucioni Kryetari i Bashkisë. Në këtë mënyrë është anashkaluar përfaqësuesin e Pronarit, veprim në kundërshtim me të gjitha kriteret ligjore të sipërcituara.

Lidhur me procedurat e privatizimit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me shkresën drejtuar subjekteve përfituese dhe për dijeni Bashkisë Divjakë, me titull “Kërkesë për prishje kontrata”, ka bërë me dije se pas verifikimit të procedurave të privatizimit dhe konstatimeve të Raportit të Auditimit të KLSH, evidentohet se..., procedura e tjetërsimit të këtyre pasurive bie ndesh me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, dhe në këto kushte, me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, kërkoj prishjen e njëanshme të kontratave të shitjes për këto objekte dhe njoftimin e palëve të interesuara.

11. Sipas Raportit të KLSH-së Bashkia Divjakë ka trashëguar 28 kontrata qiraje për objekte të kaluar në pronësi sipas VKM nr. 499, datë 19.07.2006, dhe të miratuar me VKB nr. 13, datë 11.02.2008, nga të cilat janë aktualisht janë në ndjekje 12 kontrata, janë prishur për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve dhe janë privatizuar 6 objekte dhe trualli i ish-kabinave të plazhit Divjakë. Privatizimi (shitja) e pasurive rezulton të jetë realizuar në vitin 2013 nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Privatizimi. Privatizimi është kryer në kushtet kur personi juridik i cili ka atributet ligjore për vlerësimin dhe miratimin e çdo forme të tjetërsimit të tyre, pra Këshilli i Bashkisë Divjakë, atribut i cili vjen nga ligji organik nr. 8652, date 31.07.2000, nuk ka dhënë miratimin apo pëlqimin për privatizim. Pra privatizimi i 6 objekteve shtetërore ish-kabina plazhit Divjakë është kryer pa miratimin e procedurave të privatizimit, nga Këshilli i Bashkisë Divjakë, në këto kushte procesi i privatizimit është në kundërshtim edhe me VKM nr. 428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, si dhe ligjin nr. 8744, datë 21.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 499, datë 19.07.2006, “Për transferimin në pronësi të pronave Bashkisë Divjake”, ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, pasi shitja e pronave nuk është në interes të komunitetit, si dhe nuk i shërben atij.

12. Nga verifikimi në terren që kreu grupi i auditimit të KLSH-së me përfaqësues të Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Zyrës së Kadastrës Divjakë në lidhje me gjendjen faktike dhe statusin juridik të Kabinave të Plazhit rezultoi se gjatë kalimit të inventarit të pasurive të paluajtshme, Bashkisë Divjakë i ka kaluar në pronësi edhe sipërfaqja e truallit me numër 2/14 me emërtimin “Trualli i Çadrave”, por dy Objekte “Kabina” të ndodhura mbi këtë truall, duke u lënë prej vitesh padrejtësisht në përdorim të personave private (pa asnjë lloj marrëdhënie kontraktore .

2.4 Pritshmëritë mbi zhvillimet e ardhshme të kontratave

Bashkia Divjakë konfirmon faktin se aktualisht është duke iu nënshtruar një auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe pas përfundimit të raportit të këtij institucioni do të vendosë se çfarë procedure do të ndjekë në lidhje me problematikat ligjore që evidentohen në rastin e kabinave të plazhit Divjakë. Por ky argument nuk është i mbështetur në ligj si dhe nuk justifikon dot neglizhencën e dukshme edhe nga Bashkia aktuale Divjakë. Ky organ administrativ duhet që të vendosë në vend të drejtën ligjore të shkelur duke ju drejtuar me padi gjykatës kompetente, jo vetëm që të mbledhë një pjesë të detyrimeve të pashlyera nga qiradhënia e kabinave të plazhit, por të kërkojë pavlefshmërinë e kontratave të shitjes së gabinave si dhe zgjidhjen e pasojave në lidhje me rastin konkret. Gjithashtu, në kabinat e rrënuara Bashkia Divjakë duhet të ndërhyjë menjëherë duke mundësuar restaurimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëpashme për të qenë të shfrytëzueshme në maksimum.

Nga Ministria e Mjedisit situata është shumë e errët përse i përket rrefuzimit në dhënien e informacionit të plotë si dhe me vonesë në lidhje me kontratën konçesionare. Gjithashtu, moskryerja e asnjë lloj punimi aktual në lidhje me vazhdimin e punimeve tregon për shkeljet e shumta ligjore, që duhet të kapërcehen në të ardhmen.

Lidhur me objektet e dhëna me qira, KLSH bazuar edhe në ankesën e Open Doors ka rekomanduar Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak Divjakë që të shprehen me vendim lidhur me vlerësimin dhe vijueshmërinë ligjore të praktikave duke kërkuar zbatimin e klauzolave të kontratës tip lidhur me përvetësimin e garancisë pasurore dhe shlyerjen e plotë të vlerës së detyrimit për secilin subjekt.

KAPITULLI III

3.0 SITUATA AKTUALE E ÇËSHTJEVE DHE PROBLEMATIKAVE NË ZHVILLIMIN SOCIAL NË BASHKITË E FIERIT DHE DIVJAKËS

3.1 DINAMIKAT SOCIALE TË POPULLSISË PËR BASHKITË E FIERIT DHE DIVJAKËS NË RAJONIN E FIERIT

3.1.1 Popullsia prezente

Bashkia e Fieri dhe Bashkia e Divjakës janë pjesë e Qarkut të Fierit i cili, bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo–territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” vazhdon të mbajë Fierin si qendër të tij. Bashkia e Fierit dhe e Divjakës shfaqin karakteristika të pupullsisë tipike për Qarkun Fier pa lënë mënjanë gjithësesi lënë veçoritë që karakterizojnë secilën prej tyre.

Bashkia e Fierit shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë. Ajo ka një sipërfaqe prej 620 km² dhe një popullsi prej 122,475 banorësh.

Bashkia e Fierit kufizohet me shtatë bashki të tjera: Divjakë, Lushnjë, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Reforma Administrative-Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndryshoi kufijtë dhe shtrirjen territoriale të kësaj bashkie, duke shtuar në përbërje të saj edhe njësi të reja administrative. Ajo aktualisht përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër.

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës. Kjo bashki përbëhet nga pesë njësi administrative, të cilat janë: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga Reforma Administrative dhe Territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 vetë. Territori i bashkisë së re

është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të Censurit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 172.40 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në Janar 2015 popullsia e Divjakes rezulton 53,372 banorë nga të cilët rreth 27% jetojnë në Divjakë dhe rreth 73% në zonën rurale Tërbuf, Grabian, Gradishtë dhe Remas. Pjesa më e madhe e familjeve të vendosura në Bashkinë Divjakë janë të paisur me tokë dhe punojnë në bujqësi.

3.1.2 Migrim/Emigrim

Nisur nga Censusi-I i 2011 për herë të parë rajoni i Fierit njih një rënie të numrit të popullsisë. Sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë në Shqipëri, Census 2011, Popullsia pakësohet me - 18.8% krahasuar me regjistrimin e 2001 dhe zë 11.08% të totalit të Shqipërisë. Kjo rënie nuk ndryshon statusin e tij në rang kombëtar si rajon me potencial human duke u renditur i dyti pas qarkut të Tiranës. Kjo prirje përbën risi për zhvillimet demografike të rajonit të cila vihet më në dukje nëse i referohemi të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjeve Civile të Shqipërisë, ku numri i popullsisë rezulton të jetë 491,241 banorë duke evidentuar një diferencë prej 180,241 banorë ose 36.6%. Një tjetër tipar i ri i shfaqur është rënia e numrit të popullsisë në qendrat urbane më të mëdha siç është Fieri, i cili në dhjetëvjeçarin e parë njohu rritje të popullsisë dhe kryesisht rritje të popullsisë qytetare. Në nivel njësisë administrative, rënia e popullsisë ka përfshirë të gjithë njësitë e rajonit dhe kryesisht atë Qendër, Levan, Cakran dhe Libofshë në Bashkinë e Fierit. Rënia e numrit të popullsisë është rrjedhojë e rënies së shtimit natyror dhe vazhdimit të lëvizjes migruese të popullsisë e cila që nga periudha 2001-2010 duket se nuk ka fituar akoma stabilitet. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoritë e Statistikës në rrethet Fier dhe Lushnjë rezulton se saldoja migruese karakterizohet nga vlera negative për periudhën 2001-2010, ku veçanërisht për rrethin e Fierit fluksi më i madh i largimeve ka ndodhur në vitin 2006 me -3,360 vetë dhe 2003 me -2,983 vetë, duke kaluar edhe vlerat e vitit 1994 (me -2,997 vetë). Në të ardhmen numri i popullsisë do të vazhdojë të ulet. Kjo sepse, duke vlerësuar ritmet e shtimit natyror nga viti në vit, ato paraqiten në rënie. Sipas Census-it gjysma e popullsisë së larguar krahasuar me regjistrimin e 2001 janë femra dhe 69% e tyre i përkasin grupmoshës 0-14 vjeç. Duke mbajtur parasysh rolin riprodhues të tyre kjo do të ndikojë në rënien e numrit të lindjeve e cila bashkë me rritjen e grupmoshës mbi 65 vjeç me 13% do të prodhojnë një vlerë më të ulët të shtimit natyror sesa është aktualisht.

Lëvizja migratore e popullsisë nga të dhënat e Drejtorive të Statistikave tregon se nuk ka fituar stabilitet dhjetëvjeçarin midis dy regjistrimeve. Lëvizja drejt kryeqytetit sikurse edhe largimi jashtë vendit shihen si mundësi për një jetë më të mirë dhe shanse punësimi. Shumë e spikatur kjo dëshirë shfaqet edhe tek të rinjtë e qytetit të Fierit. Në shkallë rajoni rënia e numrit të popullsisë u shoqërua edhe me rënie të numrit të dendësisë së popullsisë për njësi të sipërfaqes në 164.71 b/km^2 krahasuar me 1989. Pavarësisht nga rënia që reflektohet në këto dy dekada, regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 tregoi se dendësia mesatare në rajonin e Fierit ishte sa dyfishi i mesatares së Shqipërisë duke u renditur i treti pas qarqeve Tiranë me 454 b/km^2 dhe Durrës me 343 b/km^2 . Përqëndrimi më i madh i popullsisë vihet re në zonën urbane dhe më konkretisht në qytetin e Fier me 5044.13 b/km^2 . Shpërndarja e popullsisë bëhet nga qendrat urbane drejt periferive por në të njëjtën formë zhvillohet edhe diferencimi midis zonave brenda rajonit.

Situata rreth dendësisë të popullsisë në Bashkinë Divjakë duhet vlerësuar me kujdes, sepse ndryshe nga gjithë zonat e tjera bregdetare të Ultësirës Perëndimore ku përqëndrimi i popullsisë është i lartë këtu ajo vjen duke u zvogëluar edhe pse këto janë zonat me potenciale turistike të mëdha në shkallë vendi.

Pavarësisht faktit se në këto dy dekadat e fundit rajoni është përfshirë në lëvizjen migruese të shoqërisë shqiptare, herë si rajon pritës dhe së fundi nga regjistrimi i vitit 2011 si rajon me rënie të numrit të popullsisë, shpërndarja e popullsisë në raport me sipërfaqen është e lartë dhe nuk e ka ndryshuar pozicionin e saj në nivel kombëtar. Në nivel rajonal shpërndarja e popullsisë vazhdon të ruajë të njëjtën prirje, më e madhe në qendrat urbane duke u zvogëluar drejt zonave periferike. Shpërndarja e popullsisë bëhet nga qendrat urbane drejt periferive dhe rrallohet ndjeshëm në zonat e larta kodrinore dhe periferive duke u bërë më e theksuar përgjatë vijës bregdetare.

Dendësia e vogël, si në rastin e Bashkisë Divjakë, tregon për ekzistencën e fenomenit të braktisjes së atyre hapësirave që mbartin edhe potencialet më të mëdha ekonomike e turistike në rajon dhe në vend njëkohësisht, duke përbërë kështu një rast paradoksal të zhvillimit rajonal dhe kombëtar. Ky fenomen medohet se lidhet me investimet selektive të pushtetit qëndror në njësi administrative që nuk kanë pritshmëri për të gjeneruar zhvillim duke shmangur financimet apo hartimin e projekteve në zona me pritshmëri të lartë zhvillimi siç është rasti i bashkisë Divjakë, e cila edhe pse pa mbështetje të politikës qendrore është zhvilluar falë punës së banorëve. Nëse kësaj do ti shtohet edhe mbështetja e shtetit, kjo bashki do të prodhonte zhvillim duke frenuar procesin e braktisjes dhe mundësi punësimi për banorët e njësive të tjera të zonës. Vlerësimi me kujdes në të ardhmen i zonës bregdetare të

rajonit, duke i klasifikuar ato si zona me prioritet investimi, do të ndikonte në prespektivën e zhvillimit të rajonit, në zbutjen e pabarazive dhe rritjen e potencialit njerëzor.

Sipas regjistrimit të fundit në vitin 2011 vihet re se edhe struktura moshore ka pësuar deformime krahasuar me atë të regjistrimit të 2001. Ky deformim vihet re në rritjen e numrit të popullsisë për grupmoshën +65 vjeç e cila zë 12% të popullsisë së rajonit nga 7.1% që zinte në 2001. Kjo shënon fillimin e plakjes së popullsisë së rajonit. Ndryshim të konsiderueshëm ka pësuar edhe numri i popullsisë për grupmoshën 0-14 vjeç i cili ka një ndikim të lartë negativ po të kemi parasysh rëndësinë e madhe që ka kjo grupmoshë për zhvillimin demografik edhe atë ekonomiko-shoqëror. Ajo është zvogëluar nga 29.2% në vitin 2001 në 19.9% në regjistrimin e vitit 2011 dhe në shkallë vendi indeksi i zëvendësimit është 21%.

Elementi femër, me të cilin lidhet riprodhimi natyror, është më i prekur nga kjo rënie me -9.4% përkundrejt meshkujve. Pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar struktura moshore e rajonit, përqindjen më të madhe të popullsisë e zë grupmosha në moshën e punës (15-65 vjeç) me 68%. Kjo tregon rënien e shkallës së vitalitetit e cila lidhet me efektet që ka filluar të japë fenomeni i migrimit i zhvilluar dekadën e parë pas 1990, saldoja migruese negative që vazhdon në dekadën e dytë veçanërisht në rrethin e Fierit dhe ritmet shumë të ulëta të shtimit natyror që për vitin 2011 kanë arritur në 2.2 b/1000 banorë.

Tradicionalisht shoqërinë shqiptare e ka dominuar elementi mashkull në strukturën gjinore të popullsisë. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 2001 kjo u lëkund në raportin 100 femra për 99 meshkuj. Kjo dukuri u interpretua me faktin se gjatë emigracion janë përfshirë më shumë meshkuj të grupmoshës 15-40 vjeç. Nga regjistrimi i fundit i 2011 struktura gjinore paraqet rikthim në prirjen tradicionale 50.57% meshkuj me 49.42% femra. Kjo dukuri lidhet me karakteristikat që ka patur migrimi i brendshëm në Shqipëri në vitet 1990, ku shumica e migrantëve ishin femra. Për grupmoshën 15-40 vjeç, që është dhe mosha e riprodhimit natyror, ky raport paraqitet 54,305 meshkuj dhe 51,373 femra e shprehur në përqindje 51% meshkuj dhe 49% femra, që do të thotë një strukturë gjinore e përshtatshme për moshën e riprodhimit me qëllim që të kemi një riprodhim normal. Në karakterin hapësinor vihet re e njëjta strukturë gjinore.

Migrimi i brendshëm i shqiptarëve ka qenë gjithmonë një pjesë e pandarë dhe tepër e rëndësishme për zhvillimet demografike të Shqipërisë. Tradicionalisht shpërnguljet dhe vendosjet e popullsisë nga njëra zonë në tjetrën janë kushtëzuar nga nevoja ekonomike dhe kushtet më të mira për jetesë dhe banim, prandaj zonat e brendshme dhe ato bregdetare kanë

qenë epiqendra e vendosjeve, duke qenë se plotësojnë kushtet: si, klima, relievi, sipërfaqet e gjera bujqësore e kullota dhe afërsia me qendrat e shkëmbimeve tregtare, si portet etj.

Format e migrimit prej të cilave u prek rajoni i Fierit ishin emigracioni i jashtëm dhe më pas migrimi i brendshëm si pjesë e përfshirë në rajonin perëndimor dhe zonës bregdetare ku u përqëndruan flukset e brendshme. Drejtimi kryesor i emigrimit të jashtëm në rajon ka qenë i orientuar drejt vendeve fqinje Greqi dhe Itali duke patur parasysh edhe afërsinë gjeografike me këto dy shtete. Roli i migrimit në zhvillimin e rajonit u pa si shumë pozitiv nga banorët, duke u cilësuar si faktor kryesor në progresin e arritur deri më tani. Ndër të tjera emigracioni është vlerësuar se ka shërbyer në zbutjen e kalimit nga e djeshmja në të sotmen, si amortizator i transformimit. Me të ardhurat e siguruara prej emigracionit banorët kanë përballuar deri më sot jo vetëm nevojat familjare, por edhe i kanë investuar të ardhurat e siguruara në hapjen e bizneseve familjare, si: minimarkete, bare, restorante, hotele etj, duke zgjidhur edhe problemet e punësimit. Investimet e kryera janë falë emigracionit, duke vlerësuar veçanërisht të rëndësishme ato në ekonominë bujqësore.

Pas vitit 1997, emigrimi u zgjerua edhe përtej kontinentit të Europës, duke u drejtuar më së shumti në SHBA, Kanada, Britaninë e Madhe. Popullsia e emigruar në Kanada përfshinte pjesën dërrmuese me arsimin dhe kualifikimin më të lartë, specifikisht të arsimuar në inxhinjeri, naftë e gjeologji që ishin edhe profesionet më të kërkuara për aplikim. Në strukturën e emigrimit bazuar në kualifikimin akademik ose të njohur ndryshe si `largimi i trurit`, numri i intelektualëve të larguar nga Fieri ishte 61. Në të vërtetë është e vështirë të përcaktosh fluksin e madh të emigrimit jashtë vendit për shqiptarët që kanë statusin intelektual. Megjithatë, mbetet fakt që pas vitit 1990, janë larguar shumë intelektualë që i përkisnin elitës së vendit. Kështu, sipas të dhënave nga Institutet Shkencore dhe Universiteteve të vendit rezulton se janë largur 40% e intelektualëve duke u përfshirë në fluksin masiv të emigracionit të jashtëm.

Sipas projeksioneve të llogaritura nga INSTAT, mbështetur në regjistrimin e popullsisë së 2001, qarku Fier renditet pas Tiranës dhe Durrësit si prefekturë pritëse e lëvizjes migratore të brendshme të periudhës 1989- 2001. Ai konsiderohet prefekturë tërheqëse për emigrantët e ardhur nga Berati (23%), Elbasani (21%), Vlora (23%) dhe shtytëse drejt prefekturave Tiranë me 45.7% të të larguarve, 15.8% në prefekturën Vlorë dhe 12.3% në Durrës, në total numri i të larguarve për këtë periudhë është 16,536.

Migrimi nga fshatrat drejt qyteteve ishte dhe forma më klasike, ku fluksi i popullsisë së ardhur nga fshatrat u përqëndrua në qytetin e Fierit. Sipas regjistrimit të vitit 2001 ky qytet u

rendit ndër qytetet me ritmin më të lartë të migrimit me karakter rural dhe me një përforcim të urbanizimit të migracionit. Kjo mbështet edhe nga fakti se për periudhën 1990-2001, bashkia Fier ka pësuar rritje në masën 106% duke u cilësuar qyteti me rritje më të shpejtë në vend.

Faktorët që nxitën këtë lëvizje dhe çuan në rritjen e popullsisë në qytete dhe rënie të popullsisë në fshatra mund ti grupojmë në faktorë shtytës dhe tërheqës:

Ndër faktorët shtytës përmendim:

- Rritja e numrit të papunësisë si rezultat i mbylljes së aktiviteteve industriale dhe bllokimit të prodhimit sipas parimit të nivelit zero dhe zbatimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore;
- Pamundësi punësimi në zonat rurale pas shpërbërjes së kooperativave bujqësore, fermave e ndërmarrjeve bujqësore;
- Të ardhura të ulëta në zonat rurale që më parë kishin qenë organizuar në kooperativa dhe ndërmarrje bujqësore;
- Infrastruktura e keqe teknike, sociale dhe kulturore; Mungesë e politikave të zhvillimit rajonal në ato rurale;
- Pasiguria e jetës (përkohësisht) veçanërisht pas vitit 1991 dhe 1997 ku rajoni i Fierit është rajoni që ndjeu më fort efektin për shkak të afërsisë me qytetin e Vlorës i cili ishte dhe epiqendra e fenomenit të piramidave.

Ndër faktorët tërheqës përmendim:

- Qyteti i Fierit ofronin mundësi më të mira punësimi krahasuar me zonat rurale dhe rrethet fqinje për shkak të pozitës gjeografike, potencialeve të mëdha natyrore dhe rolit të tyre si qendra të shkëmbimeve tregtare;
- Kushte më të mira jetese;
- Sigurimi i shanseve për arsimim më të mirë për fëmijët;
- Sigurimi i mundësive për strehim dhe ushtrim të aktiviteteve të ndryshme ekonomike;
- Lidhjet familjare me banorë të këtyre qyteteve, për të mbajtur lidhje të forta farefisnore dhe miqësore me banorë që kishin ardhur gjatë sistemit socialist për qëllim ushtrimin e profesionit.
- Zbatimi i ligjit të sigurimeve shoqërore për daljen në pension më parë sesa mosha zyrtare e përcaktuar me ligj duke fituar 60% të pagës.

Bashkëveprimi i këtyre faktorëve prodhoi jo vetëm një proces intensiv migrimi por rriti edhe procesin e urbanizimit në disa qytete. Në vitin 2001 qyteti i Fierit spikati si një ndër qytetet

me koeficient urbanizimi të lartë duke u renditur kështu ndër qytetet që dallojnë për një përforsim të urbanizimit të migracionit si Tirana, Durrësi, Elbasani, Lezha.

Lindja dhe rritja e qyteteve elektorale si Divjaka u panë me shpresën se do të nxisnin zhvillimin urban nëse do t'u referoheshim potencialeve natyrore, nivelit të mirë kulturor dhe arsimor të popullsisë dhe trashëgimisë së pasur natyrore dhe kulturore. Por sipas regjistrimit të 2011 duket se ka rënë jo vetëm numri i popullsisë por edhe dendësia e saj, tregues këto që flasin se Divjaka nuk ka arritur të zhvillojë elementet e urbanizimit duke mos zhvilluar dot sektorët sekondar dhe veçanërisht atë terciar (sektorin e turizmit), por të dallohet si një qendër e rëndësishme e prodhimit bujqësor.

Ardhja e popullsisë nga zonat rurale jo vetëm zmadhoi qytete si Fieri por edhe ndryshoi raportin e popullsisë sipas vendbanimit fshat-qytet. Për rajonin e Fierit kjo konfirmohet edhe në regjistrimin e vitit 2011, ku popullsia urbane u rrit me 0.8% më shumë krahasuar me regjistrimin e vitit 2001. Nga ana tjetër, migrimi i orientuar drejt zonave rurale dominoi ndër të gjitha format migruese në rajon ku 71.7% e migrantëve u vendosën në zonat rurale përkundrajt 23.3% në zonat urbane, dhe vetëm për periudhën 2000-2001 kjo përqindje në shkallë qarku ishte 69.3%.

Sot ky raport në nivel rajoni është 37.5% popullsi urbane me 62.9% popullsi rurale. Përqindjen më të madhe të popullsisë urbane e ka Fieri me 46%.

Në rajonin e Fierit procesi i migrimit, krahas efekteve pozitive, u shoqërua edhe me efekte negative. Këndvështrimi i drejtueve lokalë lidhur me efektet negative është i ndryshëm dhe vlerësohet në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe sociale të njësive që ata përfaqësojnë. Kështu për bashkinë Fier, e cila është edhe më e madhja në rajon, efektet më negative të migrimit lidhen me ruralizimin e qytetit. Ndërsa për bashkitë më të vogla, si në rastin e Divjakës, ky proces vlerësohet me ndikim negativ në aspektin e ndryshimeve demografike. Pakësimi i numrit të popullsisë si rrjedhojë e lëvizjes së vazhdueshme të popullsisë drejt qytetit të Fierit, apo edhe qyteteve më të mëdha në vend, siç janë Tirana dhe Durrësi, vazhdon të thellojë pabarazinë në popullim, por edhe të ndikojë në zhvillimin ekonomik të njësive të lartë përmendura. Roli i emigrimit në të ardhmen vlerësohet i zbehtë dhe kjo argumentohet nga kriza në rajon sikurse edhe në nivel global. Ndërsa lidhje me migrimin e brendshëm, theksohet se ky proces po merr fund. Kjo si rezultat i pamundësisë në ofrimin e vendeve të reja të punës dhe e vlerësimit të gjendjes në qytet si e njëjtë me atë në zonat rurale.

3.1.3 Niveli Arsimit

Tendenca e përgjithshme e analfabetizmit në nivel të qarkut Fier ka qenë në rritje të konsiderueshme në periudhën 2001-2011, nga 0.94% në 3.18% (e vërejtur edhe në nivel kombëtar, nga 1.4% në 2.8%). Kjo tendencë sjell në vëmendje probleme të mundshme të braktisjes së shkollës për shkak të aksesit të dobët në të, kushteve të varfërisë, etj.

Popullsia e Bashkisë Fier ka një nivel të përgjithshëm arsimit të ngjashëm në raport me bashkitë e tjera të ngjashme dhe më favorizues në raport me bashkitë fqinje në Qarkun Fier. Shkalla e analfabetizmit në Bashkinë Fier arrin shifrën 3.2% dhe është më e lartë se niveli kombëtar dhe ai i qarkut. Sa i takon nivelin arsimor të popullsisë, në Bashkinë Fier 52.9% e banorëve kanë përfunduar vetëm nivelin bazë arsimor (fillor ose 9-vjeçar). Kjo shifër është më e ulët se mesatarja e Qarkut Fier, por e përafërt me pjesën më të madhe të bashkive të ngjashme. Siç paraqitet edhe tendenca në nivel kombëtar, kjo shifër e lartë dëshmon për një shoqëri në thelb rurale, pa akses të mirë në shërbimet arsimore.

Në nivel njësisht administrative, përqindja e popullsisë që ka përfunduar vetëm ciklin fillor apo 9- vjeçar luhet në vlera 60-70%, me përjashtim të qytetit të Fierit (36.23%). Kjo tregon për një shpërndarje të pabarabartë në territor të kapitalit njerëzor të kualifikuar, i cili është i përqendruar vetëm në qendrën kryesore të shërbimeve dhe punësimit.

Përqindja e popullsisë me vetëm arsim të mesëm të përfunduar në Bashkinë Fier paraqitet më e lartë se niveli kombëtar dhe i qarkut (32.5%, kundrejt 31.4% dhe 30%). Fieri ka potencial për të investuar në këtë popullatë, duke nxitur punësimin në sektorë shërbimesh, ose vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Ndjekja e arsimit të lartë në nivel bashkie shënon vlerën 9.7%, që është shumë më e ulët se bashkitë e ngjashme dhe se niveli kombëtar. Një arsye për këtë nivel të ulët është edhe mungesa e një Universiteti në Qarkun Fier, gjë që bën të detyrueshme zhvendosjen për arsye shkollimi.

Në tërësi, vitet mesatare të shkollimit për Bashkinë Fier dëshmojnë për norma më të ulëta se niveli kombëtar (9.9 kundrejt 10.2), mjaft më të ulëta se bashkitë konkurruese, por shumë favorizuese në nivel qarku, sidomos kundrejt bashkisë Divjakë. Kjo kërkon një mobilizim më të mirë të kapitalit njerëzor, për të fuqizuar pozicionin rajonal/në nivel qarku në lidhje me ofrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar, ose të specializuar.

Tabela. 1 Nivelet arsimore të Bashkisë Fier dhe Bashkisë Divjakë, në raport me nivelin Kombëtar dhe Qarkun Fier

Njësia	Niveli i analfabetizmit	% e popullsisë me arsim të ulët	% e popullsisë me arsim të mesëm	% e popullsisë me arsim të lart	Vitet mesatare të shkollimit
Shqipëri	2.80%	52.10%	31.40%	11.80%	10.2
Qarku Fier	3.18%	57.70%	30.04%	7.36%	9.7
Bashkia Fier	3.20%	52.90%	32.50%	9.70%	9.9
Bashkia Divjakë	3.10%	68.50%	23.30%	3.60%	9.1

Aksesi në arsim

Në Bashkinë Fier gjenden 85 kopshte, 18 shkolla fillore, 63 shkolla 9-vjeçare, 18 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 4 shkolla profesionale. Sa i takon numrit të objekteve arsimore, Bashkia Fier tejkalon mesataren në nivel qarku, dhe shumë më tepër në krahasim me Bashkinë Divjakë. Për këtë të fundit, përmirësimi i infrastrukturës ndërlidhëse, si dhe investimi në kopshte, shkolla do të përmirësonte së shumeti cilësinë e jetesës. Në bashkinë Divjakë gjithashtu është i theksuar dhe fenomeni i nivelit të ulët të arsimit për komunitetin Rom dhe egjiptian. Shkaqet e këtij fenomeni janë të shumta, por më i rëndësishmi vazhdon të mbetet varfëria ekstreme. Migrimi dhe emigrimi janë faktorë të tjerë që ndikojnë në përqindjen e regjistrimit apo të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë dhe egjiptiane. Disa fëmijë nuk regjistrohen në shkollë ose ata e braktisin atë sepse familjet e tyre migrojnë gjatë vitit akademik apo vendosin të shkojnë diku jashtë. Niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë dhe institucione arsimore. Kjo spjegon edhe faktin pse në Divjakë komuniteti egjiptian është shumë më i pa arsimuar se ai rom. Shifrat e marra nga zyra arsimore e bashkisë, tregojnë se në numrin e përgjithshëm të fëmijëve të pa-arsimuar, është shumë më i lartë ai i fëmijëve egjiptian se ai i fëmijëve rom.

Asnjë nga njësitë administrative brenda bashkisë nuk ka mungesë kopshtesh, apo shkollash 9-vjeçare (ose fillore). Gjithsesi, ky fakt nuk është tregues i mbulimit me shërbim dhe cilësisë së tyre sipas standardeve të nevojshme. Frenkuentimi i këtij sistemi shkollor në zonat urbane konsiderohet normal dhe i kënaqshëm. Në zonat ruarle vështirësitë dhe pengesat janë më të mëdha. Mosdërgimi i fëmijëve në shkollat rurale lidhet me largësinë e tyre nga shtëpitë. Ekzistojnë mjaft raste të pamundësisë ekonomike për t'i paisur fëmijët me libra si dhe nevoja

për t'i futur fëmijët sa më herët në tregun e punës. Fenomeni i zvogëlimit të numrit të studentëve në këtë cikël është i lidhur me emigrimin e popullsisë dhe me faktorë të tjerë ekonomikë. Shkollat e mesme janë të shpërndara njëtrajtësisht në territor (1 për secilën njësi), me përjashtim të Portëzës, e cila e merr shërbimin e arsimit të mesëm në qytetin e Fierit. Vlen për t'u theksuar gjithashtu se në arsimin 9-vjeçar është rritur dukshëm edhe arsimit jopublik. Në rajonin e Fierit për vitin 2010 funksiononin 43 shkolla të mesme publike dhe 13 shkolla të mesme jopublike

Në qytetin e Fierit kemi mbulimin më të mirë me objekte arsimore, ku ndodhen 2 çerdhe publike, 16 kopshte publike dhe 5 private, 12 shkolla 9-vjeçare publike dhe 8 private si dhe 13 shkolla të mesme. Nga këto, 2 janë gjimnaze publike, 8 janë shkolla të mesme private, si dhe 4 të tjerat janë shkolla profesionale. Të dhënat tregojnë se 62% e nxënësve që mbarojnë shkollat 9-vjeçare vazhdojnë ciklin e arsimit të mesëm. Në arsimin e mesëm duhet theksuar, gjithashtu se aktualisht dallime të mëdha vihen re edhe në numrin e shkollave të mesme profesionale dhe shpërndarjen e pabarabartë të tyre në rajon. Po të mbahet parasysh madhësia e rajonit, vendi që zë ai në zhvillimin ekonomik të vendit dhe potencialet që ai mbart, arrin në përfundimin se numri aktual i shkollave profesionale është shumë i vogël dhe nuk luan rol në tregun e punës të rajonit. Arsimin e mesëm shumica e të rinjve nuk e shohin si një alternativë për punësim. Mjaft prindër dhe fëmijë e shohin atë si pa lidhje me nevojat e tregut të punës. Këtyre u shtohet edhe emigracioni i cili ndikon në uljen e numrit të nxënësve për shkollat e mesme. Për të gjitha këto është e nevojshme të gjenden forma dhe rrugë të përshtatshme që vetë të rinjtë të bëhen të interesuar për domosdoshmërinë e kryerjes së arsimit të mesëm. Arsimi i mesëm jopublik krahas atij publik po luan rol përherë e më të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit arsimor në rajon

Vërehet gjithashtu edhe mungesë e institucioneve të arsimit të lartë, si publike ashtu edhe private, në të gjithë qarkun, gjë që nxit zhvendosjen e popullatës së re për arsye studimore.

Në dhjetëvjeçarët e fundit janë kryer mjaft reforma arsimore siç janë, rishikimi i programeve dhe teksteve shkollore, rritja e kualifikimi të personelit arsimor përmes trajnimesh të ndryshme, riorganizimi i organeve administrative si dhe ngritja e funksionimi i shkollave private që përbëjnë disa nga drejtimet kryesore të zhvillimit të sistemit arsimor të rajonit. Krahas përmirësimeve një varg çështjesh mbeten për t'u zgjidhur, si numri i lartë i nxënësve që braktisin shkollën, cilësi e dobët në mësimdhënie sidomos në zonat rurale, mungesa e mjediseve të përshtatshme shkollore, si dhe e mjediseve sportive e kulturore.

3.1.4 Shëndetësia

Gjendja e përgjithshme e shëndetit publik

Sistemi i kujdesit shëndetësor ka formën e një rrjeti shërbimesh ku përfshihen spitalet si edhe rrjeti i qendrave shëndetësore dhe ambulancat, të cilat janë kryesisht publike, kurse klinikat dentare dhe farmacitë janë private. Në tërësi shërbimi shëndetësor është shpërndarë në të gjithë territorin e rajonit Fier, për të mbuluar krejt popullsinë urbane dhe rurale. Vdekshmëria foshnjore si një prej treguesve që paraqet nivelin e kujdesit shëndetësor dëshmon për përmirësim të shëndetit publik. Niveli i saj ka ardhur në rënie nga 17.4% në vitin 2001 në nivel rajoni në 3.3% në 1000 banorë në vitin 2009 dhe renditet e dyta pas Tiranës. Sëmundjet kryesore që prekin më shumë popullsinë e rajonit janë sëmundjet diareike, më të përhapura gjatë stinës së verës, që zënë 50% të sëmundjeve infektive dhe vijnë kryesisht nga ndotja e ujit dhe e ajrit. Sëmundjet akute të frymëmarrjes, si astma dhe bronkitet, të përhapura në dimër kanë si shkak përdorimin e sistemeve ngrohëse pra, kryesisht, nga ajri i ndotur. Gjithashtu sëmundjet kardiovaskulare janë të dendura ndër sëmundjet kronike dhe shkaktaret kryesore të vdekjeve. Përveç këtyre pas vitit 2000 është shfaqur edhe sëmundja e HIV-AIDS me tre raste në Lushnjë, dy në Fier dhe dy në Mallakstër. Qarku Fier paraqet një gjendje shëndetësore relativisht të mirë në nivel kombëtar. Personat me të paktën një aftësi të kufizuar përbëjnë 6.55% të popullsisë, krahasueshëm me nivelin kombëtar (6.2%). Infrastruktura e sistemit shëndetësor paraqitet e ndryshme sidomos në zonat periferike të rajonit. Numri i institucioneve shëndetësore, spitalet, poliklinikat, ambulancat kanë mbetur në nivelin e dhjetëvçarit të shkuar, kurse në zonat e thella kodrinore ato janë zvogëluar në numër. Numri i mjekëve dhe personalitë të mesëm shëndetësor në zonat rurale është pakësuar dukshëm dhe popullsia përditë e më shumë i drejtohet qendrave shëndetësore kryesore të rretheve dhe të Tiranës.

Bashkia Fierit është më i plotësuar në shërbime me to dhe kryen funksionin e spitalit rajonal duke ofruar shumëllojshmëri të shërbimeve. Shërbimi shëndetësor nuk ofron as shërbim dhe as cilësi të tij dhe shpesh mungojnë edhe mjekët e ambulancat. Kushtet e përgjithshme të spitaleve dhe qendrave shëndetësore, me gjithë disa përmirësimeve të pjesshme, nuk plotësojnë nevojat e popullsisë. Problemet janë të shumta dhe kanë të bëjnë me fonde të pamjaftueshme për mirëmbajtje e infrastrukturë të mjediseve, numrin në rënie të mjekëve, cilësinë e dobët në shërbimet ndaj pacientëve, mungesën e ilaçeve dhe koston e lartë të tyre. Zakonisht në spitale nuk ofrohen kushtet higjienosanitare dhe numri i të shtruarve në një

dhomë është i lartë. Gjendja aktuale e shërbimit shëndetësor kërkon reformim rrënjësor, jo vetëm në shpërndarjen e rishpërndarjen e personelit për të mbuluar me shërbime të gjithë popullsinë veçanërisht atë të zonave të thella rurale, por mbi të gjitha në shërbimin shëndetësor kërkohet rritje e cilësisë së shërbimeve nga vetë personeli dhe kontrolli i gjithanshëm prej organeve të pushtetit vendor për të luftuar e çmontuar korrupsionin në shëndetësi.

3.1.5 Punësimi dhe Papunësia

Një ndër treguesit kryesorë për zhvillimin social ekonomik në tërësi dhe të rajoneve në veçanti është punësimi i forcave aktive për punë. Pavarësisht nga paqëndrueshmëria e tregut të punës, rajoni i Fierit deri në vitin 2001 nuk dallohet për probleme të mëdha lidhur me punësimin krahasuar me qarqe të tjera në vend. Këtë e tregon edhe shkalla e ulët e papunësisë në vitin 1999 e cila ishte 14.5 % përkundrajt 28% që ishte ajo në shkallë vendi. Pas vitit 2001 nivelet e punësimit vijnë duke u ulur. Në vitin 2010 ky nivel është ulur në masën 16.6% krahasuar me vitin 2001.

Bashkia Fier ka një situatë punësimi relativisht të mirë në raport me bashki të tjera të ngjashme, si Elbasani, Durrësi e Shkodra. Papunësia për Bashkinë Fier arrin 29.5%, e përafërt me mesataren kombëtare dhe lehtësisht më e lartë se Qarku Fier. Gjithsesi, në raport me bashkitë fqinje, Bashkia Fier shënon shkallën më të lartë të papunësisë. Nga analiza demografike vërehet se popullsia ekonomisht aktive (15-64) në Bashkinë Fier përbën 68% të popullsisë. Kjo vlerë, që i referohet një strukture demografike të re në moshë, tregon që bashkia përballet potencialisht me sfida më të mëdha për sa i përket nevojës për të krijuar mundësi punësimi, përkundrajt bashkive të tjera me struktura moshore më të plakura. Punësimi i të rinjve është problematik pothuajse në të gjitha njësitë administrative, duke u luhatur nga 50% në 65% të popullsisë të moshës 15-24 vjeç. Në nivel bashkie, të gjithë njësitë administrative kanë karakter mbizotërues bujqësor, me përjashtim të Fierit, ku 65,86% e popullsisë aktive është e punësuar në shërbime. Nga pikëpamja e statusit të punësimit, predominojnë të vetëpunësuarit ndaj të punësuarve me pagë. Ndërkohë, në Fier punësimi me pagesë përbën mbi 60% të situatës së punësimit.

Në nivel rajoni rënia më e madhe e nivelit të punësimit vihet re në degët e ndërtimtarisë, transportit, tregtisë dhe industrisë. Ndërsa, rënia e numrit të punonjësve ka përfshirë pothuajse të gjitha degët e strukturës ekonomike (në veçanti ato të sferës së prodhimit dhe

shërbimit). Në degën e arsimit dhe shëndetësisë ky tregues paraqitet me një rritje të lehtë. Shkaqet e rënies së nivelit të punësimit në rajonin e Fierit lidhen me:

- Mbylljen, ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve ekzistuese të trashëguara nga periudha e mëparshme, në veçanti ndërmarrjet e mëdha e të mesme;
- Zgjatja në kohë e procesit të privatizimit i cili vazhdon ende në industrinë e naftës;
- Vazhdimin e fenomenit të emigracionit i cili vazhdon të përfshijë ende një pjesë të forcave të punës;
- Tkurrjen e degës së ndërtimitarisë;
- Mungesën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese;
- Mungesën totale të zhvillimit të turizmit;
- Mospasqyrimin e saktë të të dhënave rreth punësimit;

Shpërndarja e numrit të të punësuarve në aspektin hapsinor tregon për pabarazi të theksuar. Dallimet e theksuara midis rajoneve lidhur me punësimin mund të spjegohen me:

- Ekzistencën e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës në rajonin e Fierit i cili bënë të mundur punësimin e 27.8% të numrit të përgjithshëm të të punësuarëve në këtë rajon përkundrejt 9.2 % të të punësuarve që mbulon kjo degë në rajonin e Lushnjes dhe 13.8% në rajonin e Mallakastrës;
- Zhvillimin më të madhë të degës së ndërtimitarisë në rajonin e Fierit;
- Rrjetin e të gjerë të ndërmarrjeve tregëtare në rajonin e Fierit;
- Mundësitë më të mëdha për punësin në sektorin privat në rajonin e Fierit;

Kështu, 66% e të punësuararve në sektorin privat në shakllë rajoni (pa bujqësinë) ndodhen në bashkinë Fier. Të dhënat e marra nga Raporti Progresin i vitit 2009 për Qarkun Fier mbi progresin e bërë mbi arritjet e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut Fier dhe të dhënat e marra nga INSTAT për shkallën e papunësisë në nivel kombëtar tregojnë se për periudhën 2002-2010 shakalla e papunësisë për rajonin ka ardhur duke u rritur përkundrejt rënies që e karakterizon atë në shkallë vendi. Në lidhje me nivelin e varfërisë dhe ndihmën ekonomike, nisur nga anketimi i kryer nga INSTAT dhe Banka Botërore, rajoni bregdetar, ku bënë pjesë dhe rajoni i Fierit, ka rritjen më të madhe të varfërisë krahasuar me vitin 2008. Rajoni i Fierit renditet ndër qarqet që dallojnë për nivel të lartë të varfërisë me 17.5% në krahasim me nivelin mesatar të varfërisë në shkallë vendi duke u renditur i dyti pas qarkut të Kukësit (i cili ka dhe shkallën më të lartë të varfërisë në Shqipëri). Një nivel i tillë varfërie në rajon mund të spjegohet me:

- Situatën e përgjithshme makroekonomike në Shqipëri dhe pasojat e krizës globale financiare;
- Lëvizjen e madhe të popullsisë drejt rajonit të Fierit kryesisht nga qarqet fqinje të cilat ndikuan në rritjen e papunësisë;
- Lëvizjen e popullsisë drejt qytetit të Fierit me shpresën për një jetë më të mire;
- Rënien e të ardhurave nga emigracioni për të cilat rajoni i Fierit zinte vendin e parë midis qarqeve në Shqipëri me 9,125 (për periudhën 2006-2007) dhe kjo vetëm për zonën rurale;
- Procesi i vazhdueshëm i privatizimit të ndërmarjeve të naftës dhe rritja e numrit të punonjësve që vazhdojnë të dalin në asistencë;
- Rënia e degës së ndërtimitarisë e cila deri diku kompesoi papunësinë e shkaktuar nga proceset e rrudhjes së ndërmarrjeve të naftës deri edhe në mbyllje;
- Mungesa e investimeve për ndërtimin e ndërmarjeve të reja ekonomike me funksion prodhues të cilat do të mund të punësonin numër të lartë punonjësish;
- Mos shfrytëzimi i potencialeve turistike dhe frenimi i investieve të huaja në sektorin turistik për shkak të problemeve të pronësisë për gjatë vijës bregdetare;

Po të analizojmë specifikisht të dhënat në lidhje me të ardhurat që i referohen bashkisë Divjakë, rezulton se qyteti i Divjakës është zona më e rëndësishme. Nëse vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave për frymë për të gjitha njësitë është 2,265 lek. Pas bashkimit në një njësi administrative, ky tregues rritet disi në 2,349 lekë për frymë për të gjithë zonën, rreth 5% më shumë se mesatarja dhe 29% më shumë se mesatarja (media) i të ardhurave të veta për frymë të njërive. Periudha e gjatë e tranzicionit të ekonomisë dhe shoqërisë, ndryshimi i strukturës së ekonomisë dhe proceset e reformave shpesh herë të pasuksesshme, fragmentarizimi i tokës, mungesa e kooperimit dhe iniciativave për të bashkuar mjetet dhe rritur potencialet e zhvillimit janë disa nga faktorët të cilët reflektojnë nivelin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonës. Bashkia e Divjakës në sajë të potencialeve të rëndësishme ekonomike (bujqësi dhe turizëm), ka një përqindje më të ulët të nivelit të papunësisë se mesatarja e vendit (14.1% krahasuar me 15.3%). Megjithatë situata sociale dhe ekonomike në Divjakë, dhe sidomos në zonën rurale është e vështirë pasi ndikohet nga emigracioni i lartë i të rinjve (kryesisht në Itali, Greqi dhe vende të tjera). Sektori mbizotërues në ekonominë e Divjakës është bujqësia, ndonëse kjo zonë ka potenciale ende të pazhvilluara në fushën e turizmit. Bashkia Divjakë ka gjithsej 828 biznese nga të cilët 335

janë të vendosur në qytetin e Lushnjës. Grabiani dhe Tërbufi, si njësi me popullsi të madhe kanë gjithashtu një numër të konsiderueshëm biznesesh.

Në këtë bashki, numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në këtë është ndër më të ultit në vend. Kjo sepse pothuajse të gjitha familjet kanë përfituar nga ligji 7501, sipas të cilit familjet rezidente në vitin 1991 kanë përfituar tokë. Megjithatë ka një numër familjesh që rezultojnë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme të cilat nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të vendosjes në territorin e bashkisë pas vitit 1991. Ky fakt është i vërtetë për rreth 30 familje rome dhe egjiptiane që përfitojnë ndihmë ekonomike si pasojë e pamjaftueshmërisë së të ardhurave për shkak të mungesës së mjeteve të jetesës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për Bashkinë e Divjakës i referohet politikave social-ekonomike për grupet etnike të matgjinalizuara. Megjithatë numri i familjeve rome dhe egjiptiane që jetojnë në bashkinë e Divjakës është i konsiderueshëm krahasuar me pjesen tjetër të popullatës që jeton në këtë bashki, nuk ka një plan vendor për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve. Varfëria e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian është shumëdimensionale dhe e vazhdueshme. Romët dhe egjiptianet në qytetin e Divjakes megjithese kanë në pronësi tokë vuajnë kushte të këqija jetese, nuk kanë akses në shërbimet publike si kujdes mjekësor dhe arsimim, në tregun e punës, në regjistrimin civil dhe siguri. Romët strehohen në shtëpi të mbipopulluara ku mungojnë kushtet elementare si kanalizimet dhe uji i pijshëm. Në zonat ku janë përqendruar romët, familjet jetojnë në kasolle ose në ndërtesa të papërshtatëshme ku mungojnë hapsirat e domosdoshme dhe kushtet higjieno sanitare.

Zvogëlimi i varfërisë ekstreme është dhe objektivi kryesor i Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit, por megjithatë varfëria mbetet ndër problemet më të mëdha që ka rajoni, ashtu si edhe në shkallë vendi. Të ardhurat mesatare në rajon janë relativisht të ulëta. Kështu 18.9% e banorëve deklarojnë një pagë mesatare deri në 10 mijë lekë në muaj, 38.5% e tyre kanë pagë mujore nga 10 - 20 mijë, 27% nga 20 -30 mijë lekë dhe vetëm 9.40% kanë pagë mbi 30 000 lekë në muaj. Këto të ardhura janë të kufizuara dhe nuk plotësojnë të gjitha nevojat jetike të familjeve. Nga pikëpamja e përdorimit të të ardhurave rezulton se ato së pari përdoren për sigurimin e ushqimeve, me mbi 70% të pages. Ndër treguesit e tjerë që lidhen me nivelin e jetesës është edhe mobilimi i banesave dhe mjediseve të banimit. Për këtë tregues (për mobilimin e shtëpive) rezulton se shpenzohet vetëm 10-20 % i të ardhurave. Përsa i përket shpenzimeve të tjera për taksa dhe qira, të dhënat tregojnë se rreth 20% e të ardhurave

shkojnë për të mbuluar këto shpenzime. Ndërkohë, një pjesë e vogël e të ardhurave përdoret edhe për pushime, 2.1% e banorëve përdorin për pushime 20-30% të pagës. Të tjerët përdorin nga 0-20%.

Në kushtet aktuale lufta kundër varfërisë nuk duhet kuptuar e kufizur thjesht në plotësimin e nevojave për ushqim veshje apo edhe mobilim, por edhe për aspekte të tjera të jetës, si për nevoja sociale e shoqërore (arsimore, shëndetësore, kulturore etj). Më e vështirë bëhet kjo situatë në kushtet aktuale kur shpesh të ardhurat (pagat) janë të pasigurta dhe të paqëndrueshme dhe jo rrallë herë pagesat kryhen me vonesë për muaj të tërë. Ndër shkaqet kryesore të varfërisë është shkalla e lartë e papunësisë në qytete dhe në ato familje rurale që kanë pak ose që nuk kanë fare mundësi punësimi dhe të ardhurash. Zgjidhjen e papunësisë drejtuesit e organeve lokale e shohin në përpjekjet që duhet të bëjnë vetë banorët për t'u punësuar si nëpërmjet përdorimit më të mirë të tokave që zotërojnë, por edhe duke shfrytëzuar mundësi të tjera që siguron liria e tregut. Duke qenë se mjaft banorë e shohin se vetë e kanë të pamundur të dalin nga gjendja e varfërisë, kërkojnë ndërhyrjen dhe ndihmën e shtetit përmes zyrave të punësimit. Në këto kushte ndihma sociale mbetet një prej rrugëve për zbutjen dhe përballimin e varfërisë. Kjo është e vetmja ndihmë që jep shteti, por ajo është mjaft e vogël dhe nuk përballon dot as ushqimin e familjes. Lidhur me zbutjen dhe zhdukjen e varfërisë janë përcaktuar shumë objektiva në strategjinë e zhvillimit rajonal, por ato nuk janë zbatuar prandaj edhe kërkohet zbatimi praktik i tyre nëpërmjet organizmave ligjorë të ngarkuara me ligj.

Në lidhje me prespektivat e zhvillimit, strategjitë, projektet, prioritetet, potencialet dhe mundësitë që ekzistojnë për t'u shfrytëzuar në të ardhmen, rajoni zotëron të gjitha potencialet, natyrore, historike dhe humane për një zhvillim më të mirë në të ardhmen. Prandaj prioritet duhet të kenë projektet që të shfrytëzojnë në masën më të madhe potencialet që mbizotërojnë në njësitë e tyre vendore, duke pasur veçanërisht parasysh në këto potenciale fuqinë punëtore dhe të ardhurat e akumuluar. Në mënyrë të veçantë theksi vihet në zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Ky sektor ka të ardhme për zhvillim në rajon, duke u pasuar nga industria agropërpunuese dhe turizmi kulturor, arkeologjik, historik e bregdetar, duke mos lënë pas edhe tregtinë, duke pasur parasysh pozicionin gjeografik të rajonit si një të shkëmbimeve tregtare.

3.2 PJESËMARRJA E KOMUNITETIT NË QEVERISJEN VENDORE, ROLI I MEDIAS DHE SHOQËRISË

3.2.1 Pjesëmarrja publike në qeverisjen vendore për bashkitë e Fierit dhe Divjakës

Pjesëmarrja publike është përfshirja e qytetarëve në vendimarrjen administrative, e cila është arritur nëpërmjet mekanizmave funksional në fusha të ndryshme dhe përmes pjesëmarrjes në këtë proces. Mekanizmat për pjesëmarrje përfshijnë; dëgjesa publike, borde këshillimore qytetare, fokus grupe me qytetarët, takime me bizneset dhe mbledhje të dhomave të tregtisë

Pjesëmarrja qytetare nënkupton përfshirjen e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim të krijimit ose përmirësimit të politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit të mirëqënjes së qytetarëve. Strategjitë e avancuara për pjesëmarrjen publike, promovojnë përgjegjësinë, rrisin besimin dhe forcojnë përkushtimin e vendim-marrësve drejt përmirësimit të qeverisjes dhe kufizojnë praktikën korruptive. Pjesëmarrja qytetare si synim ka bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve mes institucioneve, shoqërisë civile, sektorit privat dhe atij publikut në përgjithësi. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimit të ligjit në institucionet e shtetit.

Pjesëmarrja publike në administratë mund të jetë përfshirje direkte ose indirekte në formulimin ose vlerësimin e objektivave administrative, nivelet e shërbimit, udhëzimet administrative dhe rezultatet e përgjithshme. Forma e praktikave pjesëmarrëse dhe marrëveshjeve përfshin takimet publike, juritë e qytetarëve, forume për grupe të ndryshme sociale të tilla si të rinjtë apo të moshuarit, kuvendet e lagjes, referendumet multi-zgjedhore shoqëruar me debate aktive publike dhe diskutime, dhe aktivizëm të organizatave joqeveritare dhe grupeve të tjera të komunitetit.

Qëllimi i pjesëmarrjes qytetare është të promovojë transparencën, të inkurajojë qeverisjen e hapur dhe të krijojë pronësi qytetare në politikën publike. Përveç kësaj, pjesëmarrja publike:

- Krijon hapësirën për vendimmarrje të përbashkët: institucionale - qytetare.
- Rrit njohuritë e qytetarëve në lidhje me mënyrën e funksionimit të institucioneve dhe njëkohësisht krijon mekanizmat për monitorimin e procesit të vendimmarrjes në të njëjta institucione.
- Krijon mundësi për publikun për pjesëmarrje në programet dhe projektet zhvillimore.

Nder faktoret me rendesi qe duhet te merren parasysh gjate procesit te pergatitjes së strategjisë për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes eshte edhe perceptimi dhe niveli i besimit te qytetareve ne qeverinë lokale. Përveç këtyre, qeveritë lokale mund të përfshijnë qytetarët edhe në grupe studimore, të cilat mund të ofrojnë kornizat për zhvillimin e qëllimeve afatgjata të qeverisjes së mirë, komitetet për kontratat qeveritare, ku qytetarët mund të jenë pjesë e komisioneve përzgjedhëse apo komiteteve mbikëqyrëse të implementimit të tyre. Këto komisione apo komitete mund t'i japin formë kulturës të kontraktimit qeveritar. Mekanizëm tjetër për përfshirjen e qytetarëve në qeverinë lokale është përmes grupeve publike mbikëqyrëse, të cilat për dallim nga komitetet këshillëdhënëse nuk kanë ndonjë lidhje me qeverinë. Këto grupe monitorojnë zbatimin e politikave të qeverisë dhe ngrenë zërin kundër propozimeve të politikave publike që janë në kundërshtim me vlerat demokratike të bashkisë në fjalë.

Kontribut konkret ne sigurimin e pjesëmarrjes publike ne vendimmarrje, mund të japin jo vetem institucionet publike por edhe aktorë të tjerë jo-insitucional. Si aktor i parë, qeveria lokale ka përgjegjësinë ligjore për të udhëhequr në sigurimin e mundësive për përfshirjen e publikut. Vendimin për të përfshirë qytetarët, për shembull, në komitetet kontraktuese i merr qeveria. Po ashtu edhe suksesi dhe efektiviteti i dëgjësive publike, komiteteve këshillëdhënëse dhe formave tjera të organizimit, varet në masë të madhe nga përkushtimi i qeverisë ndaj transparencës dhe pjesëmarrjes publike. Aktor me rëndësi në promovimin e përfshirjes se publikut në procesin e vendimmarrjes janë edhe Organizatat e Shoqërisë Civile si edhe media. Ato kanë mundësinë të tejkalojnë rolin e tyre të monitorimit dhe të mobilizojnë publikun në përkrahje apo kundërshtim të politikave, programeve dhe projekteve. Ato në shumicën e rasteve udhëheqin grupet monitoruese dhe këshillëdhënëse dhe koordinojnë aktivitetet e grupeve të tilla, prandaj ato kanë rol themelor në krijimin e kulturave pjesëmarrëse te qytetarëve.

Sipas të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Bashkisë së Fierit shoqëria civile është duke u rritur dhe OJF-të janë duke luajtur një rol edhe më të madh në promovimin e ndryshimeve demokratike, të drejtave njerëzore, kulturës dhe rritjes së qytetit. Aktualisht Fieri ka më shumë se 20 OJF të angazhuara në punë me komunitetin Rom, anti-trafikimin, turizmin, bujqësinë, artet, mjedisin, gratë, fëmijët, të rinjtë, dhe zhvillimin e biznesit. Kurse në lidhje me angazhim e shoqërisë civile në Bashkinë e re të Divjakës, pavarësisht faktit se në numër ato janë më të vogla në krahasim me Bashkinë e Fierit, mund të sjellim shembuj të mirë angazhimit të tyre si në rastin e mbrojtjes së Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Koalicioni i Shoqërisë Civile shprehu shqetësimin në lidhje me propozimin për ndërtimin e një qendre

urbane në zemër të Parkut Kombëtar dhe në shkatërrimin në këtë formë të vlerave të tij. e gjithë kjo pasi kompania e ndërtimit prezantoi projektin për ndërtimin e një resorti turistik brenda Parkut Kombëtar në një tryezë të organizuar nga Ministria e Mjedisit. Sipas 'koalicionit', projekti i ndërtimit synonte zënien dhe tjetërsimin e 10% të territorit të Parkut, ndërkohë që infrastruktura shoqëruese (rrugë, ndriçim, rrjet elektrik, dallgëthyes. etj) do të ndikonin negativisht në gjithë sipërfaqen e tij. në të dyja bashkitë janë aktualisht prezente dhe aktive dy media kryesore lokale. Përkatësisht TV Apollon në Fier dhe RTV4 në Divjakë (Lushnje).

Sektori privat është një aktor tjetër, që është duke fituar rëndësi në çështjet civile, si përmes pjesëmarrjes në programet zhvillimore, po ashtu edhe në partneritetet publiko-private. Sektori privat mund të rrisë ndikimin e vet duke përkrahur fushatat informuese përmes mediave dhe duke luajtur rol aktiv në komitetet këshillëdhënëse.

3.2.2 Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje

Edukimi është njëri ndër faktorët kryesorë që përcakton nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Në përgjithësi, sa më i lartë niveli i edukimit të një personi, aq më e lartë është mundësia që ai/ajo të marr pjesë në vendimmarrje. Arsyeja për këtë mund të jetë fakti që personat me nivel të lartë edukimit janë në gjendje të kuptojnë më mirë rëndësinë e përfshirjes qytetare në procese, rëndësinë e përgjegjësisë qytetare, nevojën që kane institucionet lokale për përvoja dhe mendime ndryshe si dhe garantim e vendimeve në harmoni me kërkesat qytetare.

Mosha, përkatësia etnike, gjinore etj, janë po ashtu faktor të cilët shpesh përcaktojnë edhe nivelin e pjesëmarrjes së individëve në proceset e qeverisjes demokratike. Arsyet për këtë shpesh lidhen me nivelin e pakënaqësive që ata kane në raport me insitucionet, mungesën e besimit, mos-përfaqësimin e interesave të tyre nga ana e institucioneve, përjashtimin nga procesi i diskutimit dhe vendimeve të rëndësishme publike etj.

3.2.3 Mënyrat e pjesëmarrjes qytetare

- Npërmjet hulumtimit të informacionit nëpër gazeta, revista dhe materiale të tjera dhe duke vlerësuar saktësinë e tyre.
- Npërmjet votimit në zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme.

- NËPËRMJET pjesëmarrjes në diskutime publike
- NËPËRMJET nënshkrimit të peticioneve.
- NËPËRMJET letërshkrimit drejtuar përfaqësuesve të zgjedhur.
- NËPËRMJET lobimit për ligje të interesit të veçantë.
- NËPËRMJET ngritjes së zërit nëpër marshime, bojkoteve apo formave tjera të protestës.
- NËPËRMJET garantimit të zgjedhjeve.
- NËPËRMJET informimit publik dhe duke pranuar konsekuencat e demonstrimit të një ligj apo politike të pa drejtë.

3.2.4 Hapat për pjesëmarrjen qytetare

1. **Informimi i publikut.** Nënkupton mundësimin e qasjes së qytetarëve në informata lidhur me politikat, vendimet dhe veprimet e qeverisë.
2. **Edukimi dhe këshillimi.** Nënkupton informimin e qytetarëve lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
3. **Avokimi** dhe zëri i qytetarëve është një ndër aspektet thelbësore të pjesëmarrjes qytetare, që për qëllim ka të ndihmojë qytetarët të shprehin mendimet dhe brengat e tyre publikisht.
4. **Dialogu publik** në mes të qytetarëve dhe qeverisë përbën një aspekt të rëndësishëm të pjesëmarrjes qytetare.
5. **Votimi** është e drejtë dhe përgjegjësi qytetare dhe njekohesisht njihet si forma themelore e pjesëmarrjes qytetare.
6. **Politikat dhe planifikimi** janë detyra kryesore e secilës qeveri me qëllim dizenjimin dhe vëniën në praktikë të rritjes së efektivitetit të programeve qeveritare ndaj prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve.
7. **Menaxhimi** transparent, i përgjegjshëm, efektiv dhe efikas i buxheteve dhe shpenzimeve publike është çelësi i qeverisjes së mirë dhe një nga arsyet për rritje ose rënie të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.
8. **Monitorimi dhe vlerësimi** i shërbimeve publike ofron mundësinë e pjesëmarrjes qytetare në përmirësimin e këtyre shërbimeve, të cilat janë esenciale për mirëqenien dhe mbijetesën e publikut.

9. **Mbikëqyrja publike** ndihmon të luftohen korrupsioni, patronazhi dhe mungesa e përgjegjësisë në mesin e institucioneve publike.

3.3 VLERËSIMI MBI PJESËMARRJEN DHE ANGAZHIMIN QYTETAR DHE EKSPERIENCA TË PRAKTIKAVE TË MIRA BOTËRORE

3.3.1 Marrëveshjet ndërkombëtare, legjislacioni në fuqi dhe situata konkrete për Bashkitë e Shqipërisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; Nr. 9904, datë 21.4.2008; Nr. 88/2012, datë 18.9.2012, Nr. 137/2015, datë 17.12.2015 dhe Nr. 76/2016, datë 22.7.2016), si një ligj themeltar i shtetit përcakton në mënyrë të shkruar dhe shteruese të drejtën e qytetarëve për pjesëmarrje dhe angazhim në vendimmarrje. Kjo buron nga një sërë parimesh të shtetit demokratik të garantuara nga kushtetuta të tilla si: “e drejta e referendumit”, “e drejta e lirisë së fjalës “e drejta e informimit” “e drejta e grumbullimit” “e drejta e organizimit” “e drejta për të propozuar ligje” “Liria për akses në informacionin publik” e drejta për një mjedis të shëndetshëm etj.

Implementimi i të drejtave dhe lirive themelore si më sipër përmendur, rregullohet nga dispozitat kushtetuese, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore.

Ndër marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjet në fuqi mund të përmendim:

1. **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**-Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën e saj 217 A (III), në 10 dhjetor 1948 në Palais de Chaillot, Paris. Republika e Shqipërisë ka aderuar, duke e bërë këtë deklaratë pjesë të së drejtës së brëndshme duke marrë përsipër angazhimin për përmbushjen e detyrimeve të saj në vitin 1955;
2. **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut Dhe Lirive Themelore (ECHR)**-U nënshkrua më 4 nëntor 1950, në Romë, Itali dhe hyri në fuqi më 3 Shtator 1953. Republika e Shqipërisë e ka bërë pjesë të së drejtës së brëndshme

këtë konventë me anë të Ligjit Nr.8137 datë 31.07.1996. “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

3. **Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)**-Është një traktat shumëpalësh i Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me rezolutën e saj 2200 A (XXI) të dates 16 Dhjetor 1996, hyrë në fuqi më 23 Mars 1976. Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë traktat me anë të ligjit nr.7510, datë 08.08.1991” Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike``;
4. Ligj Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”- Është një nga instrumentat kryesore ligjorë të së drejtës së brendshme, që u garanton qytetarëve të drejtën për tu informuar dhe marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
5. **LIGJI NR. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”**-Në datën 30.10.2014 parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik” , ligj i cili paraqet rëndësi të veçantë për garantimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vetëqeverisjen vendore. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike qofshin këto kombëtare apo vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik;
6. Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”-Një nga ligjet më kryesore në legjislacionin shqiptar që garanton të drejtën e informimit lidhur informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritet publike. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji i mëparshëm Nr.8503, datë30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet Zyrtare” , i cili rregullonte të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Ligji “Për të drejtën e Informimit” synon garantimin e njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjëndjen e shtetit dhe të shoqërisë. Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Përtej ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve në fuqi, studimet tregojnë se, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, është pika më e dobët e vlerësimeve të dhëna mbi qeverisjen vendore në Shqipëri. Në vitin 2016, Qeveria Shqiptare në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – PNUD në Tiranë, nisi zbatimin e projektit “Konsolidimi i reformës administrative dhe territoriale”. Të 61 bashkitë ishin përfitueset e projektit, i cili kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale të administratave

vendore, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe mjedisit për angazhimin aktiv të qytetarëve që në kompleks synonin arritjen e një qeverisje të mirë vendore. U intervistuan 12 000 qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe në raport me madhësinë e secilës prej 61 bashkive. Gjithashtu, vlerësimi përfshiu 340 intervista gjysmë të strukturuar me nëpunës civilë të nivelit të lartë në secilën bashki, 61 grupe të fokusit me zyrtarë bashkiakë të nivelit të lartë, 90 dialogë me komunitetin, si dhe grumbullime referencash nga të dhënat përkatëse demografike, ekonomike, sociale, publike dhe administrative.

Pjesëmarrja dhe angazhimi i qytetarëve u vlerësohet me 50 nga 100 pikë në të gjitha bashkitë, duke përfaqësuar kështu elementin më të dobët të qeverisjes vendore. Gjetjet konstatuan një kulturë të ulët të pjesëmarrjes demokratike, e nxitur kjo si nga qytetarët dhe nga qeverisja vendore. Në pjesën më të madhe të bashkive qytetarët nuk e shihnin veten si partnerë në qeverisje dhe zhvillim. Gjetjet treguan se zyrtarët bashkiakë nëpër bashki nuk shfaqin një kulturë të fortë për angazhimin e qytetarëve ose i shohnin si jo të mirëinformuar për të dhënë këshilla cilësore. Rezultatet treguan se ndërkohë që ekziston një kuadër institucional i përmirësuar për pjesëmarrjen, si qytetarët dhe zyrtarët bashkiakë e konsiderojnë aftësinë e organizatave vendore të shoqërisë civile për të lobuar, advokuar dhe ndikuar tek administrata vendore si të pamjaftueshme. Platformat dhe strukturat e disponueshme për pjesëmarrjen e komunitetit u vlerësuan si mesatare dhe mekanizmat institucionalë të përdorur nga Koordinatorët e Konsultimit Publik dhe të Drejtës për Informim rezultuan pjesërisht efektive dhe kërkonin riorganizim.

Edhe pse pjesëmarrja qytetare është obligim kushtetues dhe ligjor, megjithatë zbatimi i saj në praktikë përcillet me sfida dhe vështirësi. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve kërkon, informacione, aftësi, mjete financiare dhe kohë. Praktika e deritashme ka dëshmuar se qytetarët janë me shume të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale në ato raste kur vendimi prek drejtpërdrejtë interesat e ngushta të tyre, familjes dhe rrethit ku ata jetojnë. Shpesh qytetarët i japin prioritet sigurimit të mbijetesës së familjeve të tyre dhe nuk kanë kohë për angazhim serioz në procesin e qeverisjes lokale. Sigurimi i informatave online, përmes ëeb-faqeve dhe formave tjera elektronike, si: vendimeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera me rendësi, është një mënyrë alternative e marrjes së informacionit dhe përfshirjes në vendimmarrje.

3.3.2 Eksperienca konkrete botërore të pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje

Demokracitë e vjetra

Anglia është një demokraci e vjetër, është kampione e praktikave të mira për pjesëmarrjen qytetarëve, si në aspektin e instrumenteve obliguese ligjore, ashtu dhe të atyre joobliguese. Autoriteti publik duhet t'i respektoj këto dispozita, dhe të përgjigjet jo më vonë se 12 ditë pas dates së pranimit, përveç në rastet kur kërkesa është e tepërt. Autoritetet publike krijojnë një skemë të publikimit, e cila duhet të miratohet nga Komisionari për mbrojtjen e të dhënave. Autoritete publike publikojnë informatat në përputhje me skemën e publikimit. Sekretaria e Shtetit nxjerr kodin e praktikës, duke përfshirë udhëzimet për autoritete publike rreth praktikës që do të ishte e dëshirueshme për t'u zbatuar.

Përveç kësaj, Anglia ka instrumente të shumta joobliguese (Kompakte, kode, programe, libra pune, plane të zbatimit, studime rasti, udhëzime, etj.) dhe një gamë të gjerë të praktikave për artikulumin e nevojës së përfshirjes së sektorit civil në procesin e vendimmarrjes si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal. Çka është më e rëndësishme, Marrëveshja për marrëdhëniet mes Qeverisë dhe sektorit të vullnetarizmit e të komunitetit ("Kompakti") – një marrëveshje mes Qeverisë dhe shoqërisë civile – është shpallur në vitin 1998 në nivel të shtetit dhe është konsideruar si instrument në për vënie në lëvizje të shumë çështjeve nga margjinat e politikave të qeverisë dhe çuarjen e tyre përpara. Pas miratimit të Marrëveshjes, Qeveria në vitin 2000 nxori Kodin e marrëveshjes për praktikë të mirë për konsultime dhe vlerësim të politikave, i cili parasheh se si proceset e konsultimeve udhëhiqen më së miri dhe se çka mund të presin njerëzit nga Qeveria, kur ajo të ketë vendosur të ndërmarrë aktivitete të konsultimeve formale, publike dhe me shkrim. Kompakti dhe kodet e ndërlidhura me të kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm si udhërrëfyes për miratimin e Kompakteve lokale. Ato shërbejnë si model dhe frymëzim për qeveritë për të përcjellë trendet kombëtare dhe për t'i zbatuar ato në nivel lokal në përputhje me nevojat e komunitetit. Aktualisht, 100% e zonave lokale në Angli janë të përkushtuara drejt një partneriteti më të mirë, duke punuar mes qeverive lokale, organeve lokale publike dhe organizatave lokale vullnetare dhe të komunitetit përmes Kompakteve lokale. Rishikimi i rregullt i marrëveshjeve lokale është i rëndësishëm për të vlerësuar suksesin e zbatimit të tyre. Shpesh herë për këtë qëllim përdoren anketat e dizenuara posaçërisht të cila u dërgohet njerëzve si në sektorin publik, ashtu edhe në atë civil. Grupi i Kompaktit vlerëson përgjigjet, përfaqëson rezultatet dhe i propozon veprime LSP-së.

Thënë në përgjithësi, Anglia evidenton një realizim shumë të mirë të partneritetit të vërtetë mes Qeverisë, pushtetit lokal dhe OShC-ve në kuptimin që mekanizmat e saj kanë qenë të suksesshëm në zbatim, si rezultat i përkushtimit dhe dedikimit të të gjitha palëve.

Shtetet e reja anëtare të BE-së

Rregullat bazë për qasje në informata dhe për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin legjislativ në Hungari janë të parapara në një sërë ligjesh. Edhe pse pjesëmarrja e qytetarëve është e rregulluar në hollësi në nivel kombëtar, disa nga dispozitat kanë ngritur shqetësime, ndërsa zbatimi i ligjeve lë shumë për të dëshiruar. Si shembull, fushëveprimi i Ligjit për pjesëmarrjen e shoqërisë vlen vetëm për projektligjet e hartuara nga ministritë, mirëpo për shkak të faktit se një numër mjaft i madh i projektligjeve janë parashtruar në parlament drejtpërsëdrejti nga deputetët, procedura e konsultimit disa herë nuk është zbatuar. Shqetësimet e tjera për ligjin kanë të bëjnë me afatin e shkurtër për procedurën e konsultimit dhe për numrin e përjashtimeve, i cili është mjaft i madh. Për dallim nga niveli kombëtar, pjesëmarrja qytetare Në Hungari është shumë e pakët në nivelin lokal. Në disa bashki nuk ekziston ndonjë dekret i veçantë lokal që rregullon pjesëmarrjen qytetare, megjithatë, kjo situatë me gjasë do të ndryshojë për shkak të obligimit, të përfshirë kohët e fundit në Ligjin për qeveritë lokale. Një nga shembujt e mirë për dekretin lokal është Dekreti për çështjet e marrëdhënieve mes OShC-ve dhe bashkisë së Budapestit dhe procedurat e tenderimit të miratuara nga Këshilli i bashkisë së Budapestit. Dekreti siguron të drejtën e OShC-ve për të shprehur mendimin e tyre, si dhe paraqet rregullat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes. Disa nga format specifike të bashkëpunimit të theksuara në Dekret janë: i) organizatat civile ftohen në takimet e Këshillit të bashkisë; ii) OShC-të mund të komentojnë këto projektligje, të cilat prekin qytetarët dhe mbulojnë pyetjet konceptuale; iii) organet konsultative ngrihen për çështje specifike, me përfshirjen e OShC-ve; iv) mbajtja e forumeve civile me qëllim informimin dhe konsultimin; v) krijimi i bordit profesional këshillëdhënës dhe konsultativ.

Ballkani perëndimor

Në rajon, Kroacia ka një historik të gjatë rregullash dhe institucionalizimi të pjesëmarrjes së qytetarëve. Niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve sigurohet përmes Ligjit mbi të drejtën për qasje në informacion. Organet qeveritare të Republikës së Kroacisë dhe personat e tjerë, tek të cilët është mbartur autoriteti publik, drejtpërdrejtë të menaxhuar apo të kontrolluar nga

organet qeveritare të Republikës së Kroacisë, gjithashtu janë të obliguar që t'i respektojnë rregulloret dhe të lejojnë qasjen tek informacioni i kërkuar ose të mos i lejojnë ato në raste specifike. Parimet, standardet dhe masat e përgjithshme për mbajtjen e konsultimeve rregullohen nga Kodi i praktikës së konsultimeve me qytetarët e interesuar në procedurat e miratimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera. Institucionalizimi i bashkëpunimit në mes Qeverisë dhe OShC-ve ka filluar me themelimin e Zyrës për bashkëpunim me OJF-të në vitin 1998 dhe është zgjeruar më tej me themelimin e Këshillit për zhvillimin e shoqërisë civile në vitin 2002.

Zyra për bashkëpunim me OJF-të ka për qëllim krijimin e një mjedisi për mundësimin e dialogut qytetar përmes mënyrave si në vijim:

- Hartimin e Kodit, mbajtjen e konsultimeve rreth tij dhe zbatimin e tij;
- Zhvillimin dhe zbatimin e udhëzimeve për zbatimin e Kodit;
- Veprimtaritë arsimore për koordinatorët e caktuar për mbajtjen e konsultimeve;
- Fuqizimin e kapaciteteve të organeve të administratës publike për zbatimin e standardeve europiane dhe metodave;
- Mbajtjen e konsultimeve me publikun e interesuar;
- Arsimimin e civilëve në nivel kombëtar, lokal dhe rajonal rreth modeleve të bashkëpunimit me OShC-të;
- Publikimin e bazës së të dhënave të 125 trupave këshillëdhënëse qeveritare dhe parlamentare që përfshijnë rreth 800 përfaqësues të OShC-ve;

Këshilli për zhvillimin e shoqërisë civile është organ këshillëdhënës i qeverisë i cili vepron për zhvillimin e bashkëpunimit mes qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Këshilli është organ i përbashkët, i përbërë prej 27 anëtarëve, prej të cilëve 12 janë përfaqësues të organeve relevante administrative të shtetit dhe të zyrave të qeverisë së Kroacisë, 12 anëtarë janë përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse dhe 3 anëtarë (1-1-1) janë përfaqësues të shoqërisë civile nga fondacionet, sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve. Dymbëdhjetë përfaqësuesit e OJF-ve zgjidhen në mënyrë demokratike përmes një thirrjeje publike për propozime dhe me procedure transparente të votimit. Këshilli jep opinione dhe deklarata me vetiniciativë rreth projektligjeve, programeve dhe planeve nacionale lidhur me zhvillimin e shoqërisë civile.

Kushtetuta e Kroacisë është një nga kushtetutat e pakta që parashtron shprehimisht të drejtën e pjesëmarrjes lokale. Sipas nenit 133: “qytetarët mund të marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në administrimin e çështjeve lokale përmes takimeve, referendumeve dhe

mënyrave të tjera të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret lokale. Një numër gjithnjë e më në rritje i qeverive lokale është duke miratuar karta lokale të bashkëpunimit mes OShC-ve dhe qeverive lokale⁷.

3.4 DINAMIKA TË STRESIT MJEDISOR DHE NDIKIMET E TIJ TEK INDIVIDËT NË KOMUNITET

3.4.1 Përkufizimi i stresi mjedisor kronik

Stresi mjedisor ndikon në jetën e secilit prej nesh dhe për këtë arsye duhet të njihet duke çuar kështu në përdorimin e strategjive që e trajtonë atë dhe që ndikojnë në një jetesë më të paqtë. Ndërveprimet midis mjedisit dhe njeriut kanë forma të ndryshme dhe në këtë formë edhe rezultatet janë të ndryshme sipas individit.

Kapaciteti i mbijetesës së qenieve njerëzore është shumë i fortë dhe zakonisht njeriu reagon pozitivisht ndaj sfidave mjedisore me të cilat ai ndeshet në kohë. Megjithatë, përshtatja pozitive ndaj sfidave dhe stresit mjedisor ka disa kosto dhe kërkon aftësi individuale të cilat mund të dështojnë ose të mos arrijnë të përballen me stresin e madh mjedisor.

Mungesa e balancës ndërmjet mjedisit dhe kapaciteteve të reagimit njerëzor përkufizohet si stres. Studime dhe vërfikime të stresit mjedisor kanë evidentuar se ka një lidhje të fortë me sëmundjen aq shumë sa, shpesh ose dhe gjithmonë, evidentohen ndryshime në sistemin imunitar, probleme kardiovaskulare, gjendje inflamatore.

Sipas hulumtimeve të tjera, stresi mjedisor është gjithashtu shkak i problemeve psikologjike dhe përkeqësimit të shëndetit mendor. Faktorët e stresit mjedisor (zhurma, ndotja, mbipopullimi) nga të cilat po prekemi gjithnjë e më shpesh, mund të jenë po aq të rënda sa në situatat kur gjendemi në nivele shumë të larta të ndotjes ose kronike si në rastin kur jetojmë pranë një aeroporti apo në një rrugë shumë të trafikuar.

⁷ Në vitin 2008 Këshilli i qytetit të Sisakut miratoi një Kartë për bashkëpunimin e qytetit të Sisakut dhe shoqatave ku shprehet gatishmëria dhe dëshira për të zhvilluar partneritet të barabartë me shoqatat. Përveç Kartës për bashkëpunim, qyteti i Sisakut gjithashtu miratoi dokumente shtesë që përmbajnë dispozita për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile siç janë nevojat e programeve publike dhe aksioneve bashkiake për të rinjtë. Karta është zhvilluar në bashkëpunim me shoqatat e qytetit dhe secila shoqatë ka të drejtë në të bashkangjitet kurdoherë Kartës. Qyteti bashkëpunon në mënyrë aktive me organizatat për zbatimin e projekteve.

Stresi mjedisor kronik ka shumë më tepër pasoja për individët. Midis stresit kronik dhe reduktimit të aftësisë imunologjike është evidentuar një lidhje e fortë, ndërkohë që stresorët akut duket se kanë më pak pasoja.

Për fat të keq, faktorët e stresit mjedisor janë pothuajse gjithmonë kronik, sepse individët nuk kanë aftësinë për t'i shmangur ose janë të kufizuar në mundësin për t'i ndaluar ato. E tillë është situata për familjet që jeton pranë një aeroporti dhe që nuk kanë mundësi të lëvizë prej andej ose për individët që jetojnë në zonat e ndotura nga zhurmat aukustike.

3.4.2 Çfarë njihet si stres mjedisor?

Hulumtimet mbi stresin mjedisor i detyrohet shumë punës së Cannon-it i cili ka studiuar reagimet e njerëzve dhe të kafshëve në situata rreziku si edhe atyre të Selye (1956). Cannon vuri në dukje se njerëzit dhe kafshët kur gjenden në situata rreziku vënë në veprim një përgjigje adaptive të quajtur reagim sulmi ose arratisje. Me këtë përgjigje, aktivizohen sistemi nervor simpatik dhe gjëndrat mbiveshkore. Në këtë mënyrë, në situatat e emergjencës, sistemi që vepron rregullon çlirimin e adrenalines e cila shkakton:

- ✓ Rritjen e papritur të presionit të gjakut
- ✓ Rritje të koagulimit
- ✓ Rritje të rrahjeve të zemrës
- ✓ Rritje të nivelit të sheqerit në gjak
- ✓ Zvogëlim të kapaciteteve tretëse
- ✓ Transferimin e të gjitha burimeve drejt muskujve

Aspekt interesant është fakti se, në momentin e kalimit të emergjencës, i gjithë sistemi kthehet në gjendjen e normalitetit. Cannon e quajti këtë proces homeostazë. Ndërsa Cannon u kujdes për përgjigjet që japim ndaj stresit akut mjedisor, Selye ishte i interesuar në përshtatjen e trupit me situata kronike stresuese. Selye e përkufizoi këtë model të reagimit të përgjithshëm si sindroma e përgjithshme e adaptimit.

Kjo sindromë përbëhet nga tre faza: një fazë alarmi e ngjashme me "sulmin ose arratisjen", një fazë rezistence në të cilën trupi menaxhon dhe përshtatet me kërkesat e reja mjedisore dhe në fund shterimi në të cilin energjitë trupore janë të ezauruara dhe ka shanse të larta për dëmtimin e sistemit.

3.4.3 Faktorët psikologjikë që i përgjigjen stresit mjedisor

Ka modele të ndryshme të përgjigjes ndaj situatave stresuese. Një nga më të njohurit është modeli transaksional i studiuar nga Lazarus dhe kolegët e tij. Sipas këtij modeli stresi është një produkt i ndërveprimit ndërmjet personit dhe mjedisit. Stresi mjedisor nuk rrjedh vetëm nga një evenimet i caktuar, por është edhe vlerësimi konjitiv i një situatë së cilës i shtohen edhe strategjitë e përbaljes me të të njohura si *coping*⁸ që aktivizohen gjatë reagimit ndaj një evenimeti.

Ekziston një tjetër teori më e fundit që përcakton përgjigjen ndaj stresit mjedisor. Kjo teori pohon se sa herë që një person përballet me stresin mjedisor, sistemi fiziologjik i stresit aktivizohet në mënyrë të tillë që të gjendet një ekuilibër i ri i cili lejon individin të funksionojë në situatën e re.

Ky proces krijon sa përfitime aq edhe kosto të shumëta për individin; ekspozimi i zgjatur ndaj kushteve stresuese, mund ta çojë trupin drejt konsumit si rezultat i kërkimit të vazhdueshëm të ekuilibrit.

Ky proces po përkufizohet gjithnjë e më shumë nga studiuesit si ndryshim adaptiv i cili përcakton më mirë ndryshimin e vazhdueshëm të lidhur me stresin mjedisor.

3.4.4 Pesë stresorët më të zakonshëm të mjedisit

Në jetën tonë të përditshme ndeshemi me stresorë të vazhdueshëm. Midis këtyre faktorëve stresues nga të cilët jemi të goditur, pesë janë ata më të zakonshmit dhe që janë studiuar gjerësisht:

- Zhurmat
- Mbipopullimi
- Cilësia e dobët e vendbanimit
- Cilësia e dobët e zonës ku jetojmë (lagjia)
- Trafiku

⁸ *Coping* përkufizohet si grupi i kapaciteteve reaktive të individit ndaj stimujve të ndryshëm që vijnë nga mjedisi të cilët përcaktojnë ndikimin që do të ketë ky tek individ. Sa më pak të jemi në gjendje të përballemi në mënyrë të përshtatshme me situatat që hasim, aq më e madhe do të jetë varësia jonë prej tyre.

